



Qendra për Arsim e Kosovës
Kosova Education Center



**Strategjia nacionale për promovimin dhe avancimin e të
drejtave të fëmijës në Kosovë
2007 – 2017
/ DRAFT - NËN HIJE /**

Përmbajtja

II. Parathënie	3
1. VËREJTJET HYRËSE	5
1.1. Pse duhet hartuar strategjinë?	5
1.2. Nga duhet filluar për të siguruar paqe pozitive?	6
1.3. Cili është shkaku i hartimit të Strategjisë nën “hije”	7
2. PARIMET THEMELORE PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË	8
2.1. Parimi moral.....	9
2.2. Parimi i empatisë.....	9
2.3. Parimi i dobisë, përfitimit dhe i filantropisë	9
2.4. Parimi i fleksibilitetit	9
2.5. Parimi i monitorimit, matjes, vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e të drejtave të fëmijës	10
2.6. Parimi holistik.....	10
Parimi i interesit kombëtar.....	10
3. Vizioni dhe misioni	11
3.1. Vizioni.....	11
3.2. Misioni	12
4. 1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE- ZHVILLIMORE	14
4.2 MASAT	15
Objektiva 1	15
4.2.1. Korniza efikase ligjore e hartuar dhe zbatimi konsekuent i saj	15
4.2.2. Sistem i krijuar funksional i mbrojtjes shëndetësore dhe i përkujdesjes për nënat dhe fëmijët.....	17
4.2.3. Sistemi i krijuar efikas dhe efektiv i zhvillimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme	20
4.4. Sistemi efikas dhe efektiv i edukimit dhe i arsimit të fëmijëve të moshës 6 – 18 vjeçare.....	24
4.7 Sistemi i krijuar efikas për parandalimin e dhunës, të të gjitha formave të eksploatimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore.....	39
4.8. Sistemi i avancuar i barazisë dhe i integritetit të fëmijëve minoritarë në shoqërinë kosovare.....	43

II. Parathënie

“Kujdesi për jetën njerëzore, lumturinë dhe mos shkatërrimi i saj është i pari dhe i vetmi qëllim i qeverisjes së mirë” Th. Jefferson, 1743 -1826, Presidenti i tretë i SHBA-ve.

Kosova është në një udhëkryq të madh historik. Puna që bëjmë sot, përcakton të ardhmen e gjeneratave që do të vijnë pas nesh. Sot krijohet themeli mbi të cilën duhet të ndërtohet jeta, begatia, mirëqenia dhe lumturia e fëmijëve tanë. Për të ndërtuar këtë themel të fortë dhe të qëndrueshëm nevojitet një qeverisje e mirë dhe efikase, një vend në të cilin sundon ligji dhe shteti ligjor, ku drejtësia dhe barazia janë të pacenueshme, ku “..asnjeri nuk është mbi ligjin dhe asnjeri nën të” ,siç thoshte T. Ruzvelt, një vend në të cilin respektohen të drejtat e fëmijës dhe secili fëmijë i Kosovës ka mundësi të zhvillohet deri në kufijtë e skajshëm të tij, deri aty ku Zoti ka thënë se mund të zhvillohet.

Nga kjo që u tha është plotësisht e qartë se kjo nuk është e lehtë të arrihet. Është një sfidë të cilën duhet tejkaluar, nëse mëtojmë të largohemi nga cepi i humnerës nëpër të cilin jemi duke ecur.

Në kohën globale dhe postmoderne është jashtëzakonisht e vështirë që me një strategji racionale kjo gjë, të programohet dhe të bëhet si duhet. Duhet gjetur një balancë ndërmjet asaj që synojmë e aspirojmë përballë kushteve dhe rrethanave në të cilat gjendemi. Kur e themi këtë duhet të kuptojmë se në ndërlidhjet dhe zhvillimet globale, pavarësisht nga vullneti dhe dëshira e madhe që kemi, për të bërë diçka të mirë e të madhe, është mjaft e vështirë që të realizohen të gjitha këto, duke marrë parasysh faktorët nga të cilët varen, faktorë që janë jashtë mjedisit – vendit tonë. Dëshira e flaktë, qëllimi dhe rruga për të parandaluar dhunën, trafikimin e qenieve njerëzore, me theks të veçantë atë të fëmijëve, pastaj luftimi i ksenofobisë, nacionalizmit ekstrem, etnocentrizmit, racizmit, homicidit etj, lidhen drejtpërdrejt edhe me masat që marrin vendet në fqinjësi dhe në botën globale në përgjithësi. Zgjidhja e problemeve të këtylla kërkon plotësimin e dy kushteve elementare:

- a. Të mendohet globalisht - të shikohet nga perspektiva e zogut, dhe të veprohet saktësisht.
- b. Të bashkëpunohet dhe të krijohen aleanca, konsorciume të fuqishme të të nxëniet e veprimit, ura dhe rrjete të fuqishme sociale për të parandaluar rrezikun e përgjithshëm që i kanoset Planetit – Tokë “shtëpisë tonë të përbashkët” nga ndotja dhe shkatërrimi irracional i “njerëzve egoistë” që dëshirojnë të jetojnë në luks në dëm të një zhvillimi të qëndrueshëm njerëzor.

Duke qenë të vetëdijshëm për kohën globale dhe postmoderne në të cilën po jetojmë, KEC-i, në kuadër të projektit “Edukimi për të drejtat e fëmijës” të financuar nga Trocair-i, ka projektuar idenë që të iniciojë hartimin e një Strategjie nacionale për fëmijët e Kosovës, pavarësisht nga prejardhja e tyre në mënyrë që të kontribuohet për krijimin e një shoqërie kohezive e miqësore për të gjithë fëmijët e Kosovës. Ne duhet të pranojmë se nuk kemi hasur përkrahje të duhur, për arsye të ndryshme të cilat nuk do t’i analizojmë. Kjo ka qenë arsyeja, kryesore pse kemi vendosur ta hartojmë këtë

draft Strategji nën "HIJE". Draftin e kësaj strategjie pas një ekspertize ndërkombëtare dhe rajonale do t'ua dërgojmë të gjitha organeve dhe organizatave publike e civile për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe ndonjë ndryshim e plotësim të nevojshëm. Ne dëshirojmë që pronarë të vërtetë të kësaj Strategjie të jenë qytetarët dhe fëmijët e Kosovës, shoqëria civile e Kosovës, institucionet publike: ekzekutive, gjyqësore dhe legjislative.

Të vetëdijshëm për ndërlidhjet globale dhe nevojat për partneritet, draftin e strategjisë pas debateve dhe diskutimeve do t'ua dërgojmë Qeverisë së Kosovës, ministrive, Kuvendit të Kosovës, kuvendeve komunale, bashkësive fetare, OJQ-ve, partive politike të përfaqësuara në parlament, të gjitha mediave, sepse të gjithë këto duhet të marrin pjesë aktive në zbatimin e objektivave zhvillimore dhe të masave të parapara me SNFK.

Kjo strategji do të jetë pjesë komplementare e dokumenteve që janë përgatitur ose janë në përgatitje e sipër si: Plani nacional i Zhvillimit të Kosovës, Plani Nacional për të Drejtat e Njeriut, Strategjia e arsimit universitar; Strategjia e arsimit para-universitar etj.

Përmes kësaj strategjie synojmë që të bëjmë diçka pozitive, "të hedhim pika uji në oqean, pa të cilat oqeani do të kishte më pak ujë" siç thoshte Nënë Tereza.

Në Kosovë gjërat kanë filluar të lëvizin pozitivisht. Thuhet se demokracia vështirë fillon të lëvizë, por kur ajo merr hapin nuk di së ndaluri ashtu si makina "perpetum mobile", makinë që vazhdimisht është në funksion dhe në lëvizje.

Kur të gjithë kosovarët do të fillojnë të hedhin nga "një pikë uji në oqean" dhe kur të gjithë të fillojnë të shtyjnë në lëvizje demokracinë e vërtetë do të sigurohet një jetë e lumtur për të gjithë qytetarët e Kosovës. Askush nuk do të pyes se: "Çfarë bëri Kosova për mua, por çfarë bëra unë për Kosovën" (huazim i ndryshuar i mendimit të Xhon Kenedit- HH)

Megjithatë, realizueshmëria e kësaj ka rrugët e saj të vështira, nëse nuk dimë të orientojemi në to. Rruga afatshkurtër nënkupton veprimin e përditshëm të qytetarëve dhe të pushtetarëve që të vendosin raporte përgjegjësie dhe llogaridhënieje, si dhe rruga afatgjatë duhet të jetë e qëndrueshme, rrugë që siguron siguri dhe koherencë në kohë të pasigurisë dhe inkoherencës. Kjo rrugë fillon dhe mbaron me përkujdesje të përhershme, me dashuri për fëmijët (reflekto për mendimin e Mahatma Gandit, në pikën 1 të këtij Drafti) dhe edukimin e arsimimin efikas dhe efektiv për të gjithë fëmijët e Kosovës, me qëllim që të gjithë këta të rriten dhe të zhvillohen deri në kufijtë e skajshëm të tyre fizikë, mendorë, shpirtërorë, moralë dhe shoqërorë, mu ashtu si thuhet në Konventën e të Drejtave të Fëmijës.

Strategjia që synojmë, ka këtë për bazë dhe qëllim.

Prishtinë
Nëntor 2006
Halim Hyseni

1. VËREJTJET HYRËSE

“ Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë një paqe të qëndrueshme duhet të fillojmë nga fëmijët”

Mahatma Gandi

1.1. Pse duhet hartuar strategjinë?


Ballkani, siç është dëshmuar shpesh në Draft - analizën për gjendjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë, ka qenë hapësirë e dhunshme me plotë luftëra të gjata dhe makabre, ksenofobi dhe urrejtje, gjakderdhje të lemerishme, nga të cilat më së shumti kanë pësuar fëmijët, civilët dhe njerëzit e pafajshëm. Në pjesën në të cilën kemi trajtuar fenomenin e dhunës në Ballkan dhe Kosovë, sipas studimeve dhe analizave tona ka dalë se luftërat zakonisht nisen dhe nxiten nga personat, individët e pa suksesshëm në jetë, të cilët që në fëmijëri kanë qenë objekt dhune, keqtrajtimi apo janë rritur në ambiente të dhunshme, në një disiplinë të ashpër, pa përkujdesjen e duhur dhe dashurinë e nevojshme. Në anën tjetër, faktorë të prishjes së paqes janë urrejtja e programuar ndaj kombeve të tjera, ksenofobia, animozitetete, siç janë glorifikimi i kombit apo etnicitetit të cilit i takon, kulturës vetjake dhe përçmimi e mohimi i kulturave dhe traditave të të tjerëve. Edhe këto orientime, zakonisht janë të nxitura dhe të përkrahura nga personat e këtyllë, që në esencë nuk i duan njerëzit, që janë egocentrikë dhe etnocentrikë, të cilët përdorin rrugë të ndryshme për të dominuar dhe u imponohen grupeve të caktuara shoqërore, kombeve dhe bashkësive etnike me të cilat ata janë identifikuar. Pas ardhjes në pushtet, sipas mentalitetit vetjak dhe botëkuptimeve të tyre ata krijojnë mekanizma, që janë në kundërshtim me orientimet filantropike dhe altruiste. Ata përdorin mjete propaganduese në sistemin arsimor dhe edukues, veçmas në histori, art, letërsi dhe në kulturën e përgjithshme të fëmijët, me qëllim që të formojnë paragjykime, stereotipa, urrejtje dhe ksenofobi ndaj asaj që është ndryshe, e huaj, e sidomos ndaj fqinjëve, sepse këta zakonisht janë konsideruar si armiq, meqë janë fajësuar si pengesë për shtrirje territoriale dhe për pushtime të tokave. Për këta njerëz, toka gjithnjë është më e vlefshme se njeriu, prandaj janë kaq të dhunshëm dhe të pamëshirshëm ndaj qenieve njerëzore duke mos i kursyer as fëmijët, duke mos e kuptuar dhe marrë parasysh Nenin 1 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, i cili thotë:” *Të gjithë qeniet njerëzore lindin të lira e të barabarta nga pikëpamja e dinjitetit dhe e të drejtave. Ato janë të pajisura me arsye dhe ndërgjegje dhe duhet të veprojnë njëra ndaj tjetrës në një frymë vëllazërie*”¹

Dhuna gjithnjë prodhon dhunë. Pasojë e dhunës është urrejtja, urrejtje të cilat krijojnë konflikte dhe më pas nga to rrjedh dhunë e ricikluar (shih skemën 1). Ky rreth vicioz, ka qenë fatal për miliona jetë të njerëzve në Ballkan, gjatë një historie shumë të gjatë. Edhe luftërat në dy dekadat e fundit që ndodhën në Ballkan e kanë këtë etiologji.

Pyetja racionale që shtrohet në këtë hyrje të kësaj strategjie është: Si të dilet nga ky rreth vicioz i atakimit të jetës së fëmijëve, që janë e vetmja vazhdimësi e qenieve njerëzore në planetin tonë?! Kjo strategji në vazhdim synon që përmes vizionit, misionit, objektivave strategjike, masave dhe aktiviteteve të krijojë një klimë dhe

¹ KEC(2006) Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimit dhe të mësimit. Tekst universitar për studentët e Fakultetit të Edukimit., Prishtinë, f. 133

hartë tjetër emocionale, sociale e mentale, në të cilën të gjithë fëmijët dhe njerëzit e kësaj hapësire do të krijojnë një paqe pozitive².



Sk. 1.1. Rrethi vicioz i dhunës

1.2 Nga duhet filluar për të siguruar paqe pozitive?

Pikërisht duhet të fillojmë nga mendimi i njeriut të paqes, Mathatma Gandit, për fëmijët. *“Në qoftë se dëshirojmë të krijojmë një paqe të qëndrueshme duhet të fillojmë nga fëmijët”*

Për të krijuar një paqe të qëndrueshme do të hartohet kjo strategji në të cilën do të përpiqemi që në hyrje të spikasim disa çështje kryesore, që nuk varen vetëm nga Kosova dhe kosovarët.

E para, për të krijuar një ambient jo të dhunshëm, nevojitet krijimi i urave të miqësisë dhe mirëbesimit ndërmjet popujve të Ballkanit. Në të gjitha vendet e rajonit duhet të luftohet nacionalizimi, etnocentrizmi, ksenofobia, etj.

Për ta bërë këtë, të gjitha sistemet e arsimit duhet të rishikojnë përmbajtjet e historisë, artit, letërsisë dhe ato të pasurohen me mesazhe miqësie dhe mirëkuptimi ndërmjet popujve. Historia duhet të jetë ajo që është, e vërtetë, por të lidhet me kohën dhe të përçojë mesazhe humaniste dhe mirëkuptim ndërmjet njerëzve.

E dyta, Kosova duhet të jetë shtet ligjor, shtet ku sundon ligji, ku të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit. Aty ku nuk sundon ligji, nuk ka barazi dhe drejtësi sociale, aty ka konflikte, dhunë, e cila prodhon dhunën tek fëmijët. Dhuna te fëmijët pengon zhvillimin normal fizik dhe psikik të tyre, ul perceptimin real për veten, fëmijët bëhen agresivë, smirëzi dhe të prirë për konflikte. Nëpërmjet sistemeve të shumta të mekanizmave mbrojtës, këta fëmijë kur rriten, për të kompensuar mungesën e përkujdesjes së duhur, kërkojnë rrugët e autoritarizmit, dominimit, si formë ose ndëshkimit e plotësimit të nevojave të pa plotësuara nga koha e fëmijërisë. Këtë proces ish kryetari amerikan Xhon Kenedi e thotë shumë qartë me fjalët: *“Ardhmëria e çdo populli mund të matet drejtpërdrejt nga gjendja ekzistuese e rinisë së tij”*.

² John Gultang dallon paqen pozitive dhe negative.. Paqe negative është një paqe ku mungon lufta ndërmjet shteteve, ndërsa paqe pozitive do të thotë jo vetëm mungesa e luftërave ndërmjet shteteve, por edhe jeta në drejtësi, barazi dhe zhvillim të të gjithë qytetarëve (Shih: KEC(2004) Të drejtat e fëmijës. Manual për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës

1.3 Cili është shkaku i hartimit të Strategjisë nën “hije”

Arsyeja kryesore e hartimit të kësaj strategjie qëndron në faktin se synojmë të nisim një dialog konstruktiv ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve e organizmave të pushtetit, për promovimin dhe fuqizimin e të drejtave të fëmijës. Në këtë orientim kanë ndikuar edhe projektet të cilat janë realizuar që nga themelimi i KEC-it. Gjatë jetësimit dhe zbatimit të Programit të Arsimit Cilësor (PAC), kemi konstatuar një lidhje korrelative ndërmjet aftësisë të mësimdhënësve dhe të drejtave të fëmijës.

Hartimi i kësaj strategjie në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërlihet me projektin “Edukimi për të drejtat e fëmijës”, i cili është financuar nga TROICAIRE dhe Organizata Irlandeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim.

Qëllimi i projektit është:

“ Të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë demokratike në Kosovë duke përmbushur standardet e pranuar ndërkombëtare për respektimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi, dhe të fëmijës në veçanti “

Për të arritur këtë qëllim janë paraparë këto objektiva:

1. Të ndërtohen kapacitete vendore për trajnime.
2. Të ndërtohen kapacitete për këshillime për të drejtat e fëmijës, në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta (arsimi i detyruar).
3. Të përmirësohen të drejtat e fëmijës në shkollat fillore dhe të mesme të ulëta.
4. Të themelohen Komitetet shkollorë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
5. Të hartohet kurrikuli për të drejtat e fëmijës në Fakultetin e Edukimit.
6. Të shtohet vetëdija për të drejtat e fëmijës.
7. Të hartohet një strategji nacionale për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë.

Strategjia nuk mund të hartohet, pa një revizion a vlerësim objektiv të gjendjes së të drejtave të fëmijës, andaj pjesë përbërëse e kësaj strategjie është edhe: Studimi për gjendjen e të drejtave të fëmijës në Kosovë. Këto dokumente komplementare do të lëshohen në diskutim publik si në shoqërinë civile ashtu edhe në organet dhe organizmat e pushtetit të Kosovës.

Strategjia Nacionale për Promovimin dhe Avancimin e të Drejtave të Fëmijës paraqet operacionalizim të mëtejshëm të Strategjisë së Arsimit Para-universitar për periudhën 2007 – 2017, e cila po ashtu pritet të miratohet gjatë këtij viti.

PJESA E DYTË

*“ ZBATIMI I KONVENTËS NUK ËSHTË ÇËSHTJE E ZGJIDHJES SË
MIRËQENIES, POR E PËRMBUSHJES SË DETYRIMEVE JURIDIKE”
“ NJERËZIMI I DETYROHET FËMIJËS ME MË TË MIRËN QË KA PËR T’ IA
DHURUAR “
Deklarata e KB-së për të Drejtat e Fëmijës, 1959*

‘Natyrisht që njerëzit e rëndomtë nuk e dëshirojnë luftën; as në Rusi, as në Angli, as në Amerikë, e as në Gjermani. Kjo është e ditur. Por pas të gjithave është lideri i shtetit ai i cili e përcakton politikën, dhe kjo gjithmonë është arsyeja e thjeshtë që njerëzit i tërheqë zvarrë përpara, pa marrë parasysh a është demokrat apo diktator fashist, a është parlamentar apo diktator komunist. Me kundërshtime apo në heshtje njerëzit gjithmonë duhet t’u binden urdhrave të liderëve të tyre. Kjo është lehtë. E tëra që duhet të bësh është t’u thuash se ata janë të sulmuar dhe të gjykosh paqësorët që nuk janë patriotë dhe e kanë vënë shtetin në rrezik. Kjo ndodh në çdo vend të botës’

*Goering, 1893 – 1946,
Lider nazist dhe kriminel lufte*

Vërtetë, jo rrallë” Patriotizmi është strehimore për horra”

2. PARIMET THEMELORE PËR HARTIMIN DHE ZBATIMIN E STRATEGJISË

Shumë Strategji pas vitit 1999 janë hartuar, por nuk kanë arritur të jetësohen. Ka shumë arsye pse këto strategji nuk janë realizuar. Ne nuk do të futemi në analizën e shkaqeve të tilla se pse këto strategji nuk kanë arritur atë që është synuar, por duke u nisur nga këto përvoja kemi arritur në përfundim për katër çështje kryesore, që garantojnë zbatimin e suksesshëm të strategjisë dhe shndërrimin e saj në një promotor të promovimit dhe të avancimit të të drejtave të të gjithë fëmijëve të Kosovës, pavarësisht nga prejardhja etnike, racore, gjuhësore, fetare, gjinore, ekonomike dhe sociale e zhvillimore. Këto katër çështje janë:

- a. Strategjia duhet të hartohet mbi bazën e një analize të thellë të gjendjes objektive të të drejtave të fëmijës, sepse nuk ka terapi të suksesshme pa diagnostifikim objektiv të pikave të forta dhe të dobëta;
- b. Hartimi i strategjisë, zbatimi dhe monitorimi i saj duhet të bëhet mbi bazën e disa parimeve themelore;
- c. Strategjia duhet të operacionalizohet me plane veprimi. Secila masë e paraparë e strategjisë do të jetësohet nëpërmjet një plani të detajuar veprimi me afate, bartës, aktivitete dhe kosto të shpenzimeve materiale dhe financiare të planifikuara me vëmendje;
- d. Sistemi i sofistikuar i monitorimit dhe i vlerësimit të zbatimit të planeve operative të strategjisë.

Të gjitha këto dokumente do të jenë pjesë përbërëse të strategjisë.

2.1 Parimi moral

Sipas këtij parimi të gjithë fëmijët e Kosovës, pavarësisht nga mosha e tyre, zhvillimi psikik dhe fizik, prejardhja etnike, racore, fetare, ekonomike dhe sociale dhe çfarëdo prejardhje tjetër, duhet të përfitojnë nga zbatimi i kësaj strategjie. Strategjia e hartuar me fjalë të tjera duhet të kontribuojë në zhvillimin maksimal të të gjithë fëmijëve të Kosovës. Kjo nënkupton që fëmijët e Kosovës të edukohen dhe të zhvillohen në pajtim me kërkesat e kohës postmoderne, të jenë të përgjegjshëm, të aftësohen që të mësojnë gjatë gjithë jetës, t'i posedojnë shkathtësitë themelore jetësore për shekullin XXI dhe të përvetësojnë Qëllimet e Zhvillimit të Mileniumit.

2.2 Parimi i empatisë

Racat e ndryshme, bashkësitë e ndryshme etnike, fetare, grupet e ndryshme të interesit, qendrat e ndryshme të monopolit dhe të gjitha ato që janë të ndryshme dhe që paraqesin një diversitet, në këtë strategji trajtohen si pasuri dhe begati. Mirëpo, realizimi i parimit moral kërkon që ndërmjet grupeve të ndryshme të interesit, , të vendoset një ndërveprim, bile bile edhe një interes i përbashkët. Mirëpo, këtu ka një problem të madh, sepse sipas njohjeve shkencore psikologjike ekziston një tendencë e fuqishme që njerëzit, në rastin tonë fëmijët që janë të ndryshëm nga ne, t'i mbajmë në distancë. Megjithatë, tek fëmijët ky problem është më pak i theksuar se tek të rriturit. Studimet psikologjike tregojnë se njerëzit janë të prirë që më shumë t'i ndihmojnë njerëzit që janë të ngjashëm me ta. Për të zbatuar këtë strategji, nëpërmjet mekanizmave dhe të veprimeve që parashihen, duhet zhvilluar një empati e fuqishme ndërmjet fëmijëve me prejardhje të ndryshme. Krijimi i empatisë ndërmjet fëmijëve të përkatësive të ndryshme nuk është detyrë e lehtë, por kjo është e domosdoshme, sepse përndryshe strategjia hartohet kot dhe nuk e prodhon promovimin e të drejtave të fëmijëve.

2.3 Parimi i dobisë, përfitimit dhe i filantropisë

Strategjia duhet të përshkohet me mesazhe të fuqishme të humanizmit, dashurisë ndaj njeriut, ndershmërisë, objektivitetit dhe të sinqeritetit të skajshëm. Ata që kanë paragjykitime dhe stereotipa , animozitete dhe elemente të ksenofobisë nuk mund të jenë bartës dhe realizues të strategjisë. Ky parim, kërkon që fëmija të vendoset në qendër dhe që secili vendim që merret për fëmijët duhet të nisët nga interesi mbizotërues (Neni 3 pika 1 e KDF-së). Respektimi i këtij parimi pamundëson çfarëdo forme dhune, eksploatimi, diskriminimi, keqtrajtimi dhe moskujdesi ndaj fëmijës.

2.4 Parimi i fleksibilitetit

Në shekullin XXI, ndryshimet janë të shpeshta dhe të shpejta. Gjërat që do të ndodhin në të ardhmen është vështirë të parashikohen me saktësi. Shumë gjëra që mendojmë t'i ndryshojmë, mund të ndryshojnë deri sa ne jemi duke përgatitur ndryshimin. Për këtë arsye, masat, veprimet dhe aktivitetet që parashihen me strategjinë duhet të jenë me elastike, të hapura për të mundësuar përshtatjen e ndryshimeve të ardhshme dhe të paplanifikuara. Për këtë qëllim, me këtë strategji parashihet krijimi i rrjeteve

sociale, që mund të akomodohen dhe përshtaten me ndryshimet që mund të jenë të paparashikueshme.

2.5 Parimi i monitorimit, matjes, vlerësimit dhe raportimit për gjendjen e të drejtave të fëmijës

Strategjia për promovimin dhe avancimin e gjendjes së të drejtave të fëmijës nënkupton krijimin e një sistemi shumë funksional dhe të sofistikuar të monitorimit, vlerësimit dhe të raportimit të përhershëm. Kjo duhet të bëhet në vazhdimësi dhe në përputhje me gjendjen e të drejtave të fëmijës në mënyrë që organet shtetërore, OJQ-të, të kenë përhërë informacion valid kthyes për gjendjen e të drejtave të fëmijës dhe të jenë në gjendje të ndërmarrin masa dhe veprime gjegjëse për avancimin dhe promovimin e përhershëm të tyre.

2.6 Parimi holistik

Strategjia duhet të trajtojë të drejtat e fëmijës në mënyrë tërësore, nga të gjitha këndet dhe aspektet e ndryshme. Kjo do të thotë se të gjitha të drejtat, duhet të trajtohen si të barabarta, të pandashme. Ky parim, siguron që Strategjia t'i ketë në konsideratë të gjitha nevojat të cilat në mënyrë eksplicite ndikojnë në zhvillimin maksimal fizik, mendor, shpirtëror dhe shoqëror të fëmijëve të Kosovës

Parimi i interesit kombëtar

E ardhmja e Kosovës, është një garë ndërmjet zbatimit të të drejtave të fëmijës dhe të katastrofës. Duke u nisur nga ky parim, promovimi i plotë i të drejtave të fëmijës në Kosovë është interes nacional, andaj të gjitha subjektet administrative publike dhe e gjithë shoqëria civile kanë për obligim që maksimalisht të angazhohen, që fëmijët e Kosovës, pa asnjë dallim, t'i realizojnë të gjitha të drejtat e tyre.

PJESA E TRETË

“ A mund të këtë ndonjë detyrë më të frikshme se sa obligimi i ynë për të mbrojtur të drejtën e fëmijës me një vigjilencë të njëjtë siç i mbrojmë të drejtat e çdo personi tjetër? A mund të këtë ndonjë test më të madh për udhëheqje se sa kërkesa për sigurimin e këtyre të drejtave për çdo fëmijë, në çdo shtet pa përjashtim?”

*Kofi Annan,
Sekretar i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara*

3. Vizioni dhe misioni

Me Strategjinë Nacionale për Promovimin dhe Avancimin e të Drejtave të Fëmijës ne synojmë të kontribuojmë në formimin e një shoqërie kohezive, demokratike në të cilën do të dominojë shteti ligjor dhe sundimi i ligjit. Në këtë mënyrë të banorët e këtij vendi, pavarësisht nga prejardhja e tyre, ata duhet të jenë të lumtur, të kenë mundësi dhe zgjedhje të barabartë. Strategjia duke mundësuar zhvillimin njerëzor dhe kapitalin social do të ndikojë që fati i tyre të mos jetë i parapërcaktuar, qoftë për të mirë ose për të keq, vetëm për shkak të vendit të lindjes, gjuhës që flasin, gjinisë apo të besimit që kanë, ngjyrës apo racës që i përkasin

Shoqëria, të cilën synojmë ta zhvillojmë përmes kësaj strategjie, duhet të jetë e bazuar në një empati të fuqishme ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, fetare, gjinore, shtresave të ndryshme sociale, sepse vetëm në një mjedis të këtillë, është i mundur zhvillimi i plotë fizik, mendor, shpirtëror dhe shoqëror i të gjithë fëmijëve të Kosovës

3.1. Vizioni

“ Ç’ mund të ishte më e keqe se verbëria e trashëguar?... Të kesh sy e të mos kesh vizion

Hellen Keller

Në punëtoritë e shumta të zhvilluara, nga analizat dhe studimet e gjithanshme të gjendjes së të drejtave të fëmijës, nga njohja e instrumenteve dhe standardeve të avancuara ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe të fëmijës, nga synimet dhe pikëpamjet humaniste e parimet e përcaktuara për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, është formuluar ky vizion, që mendojmë të jetë një ëndërr e bukur që duhet ta përjetojmë në zhgjendërr për promovimin dhe avancimin e gjendjes së të drejtave të fëmijës në Kosovë:

“Kosova – vend miqësor për fëmijë që mundëson dhe krijon kushte për zhvillimin maksimal fizik, mendor, shpirtëror dhe shoqëror të të gjithë fëmijëve të Kosovës, pavarësisht nga prejardhja e tyre”.

Realizimi i këtij vizioni paraqet një sfidë të vërtetë dhe shumë të vështirë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Në rend të parë kjo ka të bëjë me institucionet legjislativë, ekzekutive, gjyqësorë, shoqërinë civile të Kosovës, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare.

Ky vizion duhet të jetë zë i përbashkët i të gjithë banorëve të Kosovës, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, racore, fetare, gjinore, shtresa sociale dhe ekonomike të

cilës i takojnë, nivelit arsimor me të cilin disponojnë. Ky zë duhet të jetë i përbashkët, sepse është pa përjashtim, interes i të gjithëve, meqë nga realizimi i këtij vizioni të gjithë qytetarët do të përfitojnë, askush nuk do të humb – të gjithë ne do të jemi fitues. Nëse ky vizion bëhet realisht dhe objektivisht “zë” i të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe nëse të gjithë banorët e Kosovës, të gjitha institucionet e saj qeveritare dhe joqeveritare punojnë në jetësimin e këtij vizioni, atëherë kjo Strategji do të jetë pronë e të gjithë qytetarëve të Kosovës

Vizioni i paraparë është një ëndërr për të cilën ia vlen që të gjithë të angazhohemi, sepse në këtë mënyrë shoqëria kosovare do të jetë e lumtur, prosperuese, demokratike dhe kohezive. Shkalla e empatisë në diversitetin kulturor, etnik, fetar dhe gjinor do të jetë një urë e fuqishme lidhëse në mozaikun ndër dhe multikulturor, e cila do të jetë pengesë e pa papërballueshme për ksenofobët, racistët e nacionalistët e të gjitha ngjyrave dhe të racave.

Për të përballuar këtë sfidë, duhet të ndërmerret një numër shumë i madh masash dhe veprimesh me të cilat do të krijohet një mjedis ku do të sundojë ligji, drejtësia sociale dhe barazia. Liria e shprehjes së mendimit, fjalës dhe besimit do të jenë vlera besimi dhe zhvillimi. Për të realizuar këtë vizion, ku do që të jesh në Kosovë, në cilin do mjedis dhe çfarë do që të jesh, nuk do të jetë hendikep dhe fatkeqësi, por përparësi, begati dhe lumturi.

Zgjidhja e statusit politik dhe social të Kosovës do të krijojë lehtësi të mëdha në realizimin e këtij vizioni, demokratizimin e rajonit të Ballkanit dhe evropianizimin e tij duke krijuar rrjete bashkëpunimesh dhe miqësish. E gjithë kjo do të ndikojë që sa me shpejt të shërohen plagët e luftës dhe distanca ekzistuese ndëretnike.

Përfitimet e të gjithë qytetarëve nga kjo Strategji, janë një emërues i përbashkët për të gjetur një konsensus nacional, fetar, gjinor dhe gjithë qytetar.

Në realizimin e këtij vizioni ndikim të madh do të kenë edhe mjetet e informacionit, veçmas ato elektronike, të cilat do të duhej që këtë “zë” të përbashkët ta përhapin nëpërmjet valëve të tyre. Ato duhet të organizojnë debate, të japin shpjegime dhe argumentime, për ta bërë të qartë se ky vizion është çelësi kryesor që Kosova të dalë nga kriza e përgjithshme morale, ekonomike dhe politike.

Për të jetësuar këtë vizion në Kosovë, ne do të kërkojmë përkrahje dhe ndihmë edhe nga vendet fqinje dhe popujt e të gjitha vendeve të rajonit, në mënyrë që edhe ata të jenë zë i fuqishëm i këtij vizioni.

Duke vepruar në këtë mënyrë, Kosova do të largohet shumë shpejtë nga cepi i humnerës, nëpër të cilin ka ecur me dekada. Në këtë garë do të fitojë lumturia dhe do të evitohet katastrofa njerëzore.

3.2 Misioni

Organet qeveritare të Kosovës, shoqëria civile, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare do të duhet të krijojnë kushte optimale për jetësimin e vizionit. Kjo strategji ka për mision:

Ndërtimin e një sistemi gjithëpërfshirës që siguron kushte për një shoqëri kohezive, në të cilën të gjithë fëmijët e Kosovës do të mund të zhvillohen dhe rriten në barazi dhe drejtësi sociale, arsimore e shëndetësore duke u pajisur me vlera humane të tolerancës, miqësisë ndërmjet popujve, paqes dhe mirëkuptimit në Kosovë dhe më gjerë.

Duke ndërtuar një sistem të drejtësisë sociale, të barazisë së njerëzve para ligjit, duke krijuar një siguri të plotë për lëvizje të sigurt, duke luftuar krimin dhe korrupsionin,

duke avancuar sistemin shëndetësor, duke rritur efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të arsimit, duke zhvilluar kapacitete dhe kompetencat e individëve për aktivitete ekonomike, duke siguruar punësim dhe mjedis të shëndoshë, krijohen mundësi koherente, reale për zbatimin e standardeve dhe të instrumenteve ndërkombëtare të avancuara për të drejtat e njeriut, zbatimi i të cilave fillon me zbatimin dhe jetësimin e të drejtave të fëmijës.

Misioni paraqet një itinerar të programuar mirë për zbatimin e “zërit” të qytetarëve, për një jetë të lumtur të fëmijëve, të familjeve dhe të të gjithë bashkëqytetarëve të tyre.

Misioni thënë në mënyrë metaforike, është një sfond i domosdoshëm pa të cilin nuk mund të realizohet vizioni, - ëndrra e përbashkët e popullit të Kosovës dhe jo vetëm e tij.

4. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

DHE

MASAT

4.1. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE- ZHVILLIMORE

Objektivat strategjike janë rezultatet (ndryshimet) apo arritjet e matshme dhe të dukshme të avancimeve në gjendjen e të drejtave të fëmijës që janë pasojë e Strategjisë Nacionale për Promovimin dhe Avancimin e të drejtave të fëmijës në periudhën 2007 - 2017. Arritja e këtyre objektivave krijon mundësitë për jetësimin e vizionit të paraparë.

Në procesin e hulumtimit, analizave SWOT, në punëtoritë e mbajtura dhe nga studimi i gjendjes së të drejtave të fëmijës, janë identifikuar këto objektiva strategjike zhvillimore:

- 4.1. Kornizë efikase ligjore e hartuar dhe zbatim konsekuent i saj;
- 4.2. Sistem i krijuar funksional i mbrojtjes shëndetësore dhe i përkujdesjes sociale të nënave dhe të fëmijëve të porsalindur;
- 4.3. Sistem i krijuar efikas dhe efektiv i zhvillimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme;
- 4.4. Sistem efikas dhe efektiv i edukimit dhe i arsimit të fëmijëve të moshës 6 – 18 vjeçare;
- 4.5. Sistem i avancuar i arsimit special për fëmijët me pengesa të lehta në zhvillim dhe i përkujdesjes së plotë sociale dhe shëndetësore për fëmijët me pengesa të rënda në zhvillim;
- 4.6. Krijimi i sistemit për zhvillimin e fëmijëve nëpërmjet aktiviteteve çlodhëse gjatë kohës së lirë p.sh. lojërat e ndryshme;
- 4.7. Krijimi i sistemit efikas për parandalimin e dhunës, të të gjitha formave të eksploatimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore;
- 4.8. Krijimi i sistemit të avancuar për barazinë dhe integrimin e fëmijëve minoritarë në shoqërinë kosovare.

Grupet e punës, analizat SWOT, struktura e studimit, studimet metaanalitike, kanë qenë vendimtare që të përcaktoheni për këto objektiva strategjike zhvillimore.

Këto objektiva strategjike, në tërësi, inkorporojnë obligimet dhe detyrimet që ka Kosova në zbatimin e Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, të Paktit

Ndërkombëtar për të Drejtat Politike dhe Civile, të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Politike, Civile dhe Ekonomike, të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore.

Objektivat strategjike zhvillimore i përmbushin kriteret dhe kërkesat tjera, që lidhen me instrumentet dhe standardet ndërkombëtare.

Renditja e objektivave zhvillimore strategjike paraqet një renditje logjike, edhe pse shumica e objektivave strategjike zhvillohen në mënyrë paralele.

Për t'u jetësuar objektivat strategjike, në strategji, janë paraparë edhe këta elementë strukturalë:

- ✚ Treguesit objektivisht të verifikueshëm që argumentojnë për arritjen e objektivave strategjike zhvillimore.
- ✚ Masat (bashkësi e aktiviteteve) dhe të veprimeve që duhet të rezultojnë me arritjen e objektivave strategjike zhvillimore. Në esencë secila masë paraqet një projekt në vete. Një apo më shumë projekte mund të jenë pjesë integrale e një plani të veprimit.
- ✚ Supozimet kritike, paraqesin një probabilitet rreziku, që mund të sjellë në përfundim realizimin e masave dhe të aktiviteteve.

4.2 MASAT

Objektiva 1

4.2.1. Korniza efikase ligjore e hartuar dhe zbatimi konsekuent i saj

Krijimi i një ambienti të qetë dhe të sigurt është kusht themelor dhe i domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në përgjithësi dhe të fëmijës në veçanti. Sundimi i ligjit dhe i shtetit ligjor janë të domosdoshëm për lëvizjen e lirë, për drejtësinë dhe barazinë sociale, për barazinë e qytetarëve para ligjit, për mbrojtjen sociale dhe shëndetësore, për qasje të barabartë dhe të drejtën në arsim, për mbrojtjen e qytetarëve nga dhuna, eksploatimin, sigurimin dhe barazinë e bashkësive etnike minoritare.

Konferenca botërore për të Drejtat e Njeriut në Vjenë e vitit 1993, riafirmoi lidhjen e pandashme në mes të parimit të sundimit të ligjit, mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut. *Në këtë konferencë u pranua se mungesa e sundimit të ligjit, është një nga pengesat më të mëdha në zbatimin e të drejtave të fëmijës.* Sundimi i ligjit siguron bazën për menaxhim të drejtë, ndër popuj dhe, në këtë mënyrë, përkrah diversitetin duke fuqizuar empatinë ndërmjet njerëzve të ndryshëm. Sundimi i ligjit është shtyllë e procesit demokratik, ndërsa demokracia është kusht për promovimin dhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Gjithashtu, sundimi i ligjit, siguron përgjegjësinë dhe kontrollin ligjor ndaj udhëheqësve dhe kështu zgjeron hapësirën e lirive të njeriut dhe të fëmijës.

Korniza ligjore është një ndër parakushtet themelore për respektimin, mbrojtjen, promovimin dhe avancimin e gjendjes së të drejtave të njeriut, lirive themelore dhe të drejtave të fëmijës nga të cilat fillon zbatimi dhe respektimi i të drejtave të njeriut.

“Sundimi i ligjit është më shumë se vetëm përdorim formal i instrumenteve ligjore – gjithashtu është sundim i drejtësisë dhe mbrojtje e të gjithë anëtarëve nga përdorimi i tepërt i dhunës shtetërore”.

Komisioni ndërkombëtar i juristëve

Përfundimisht secila shoqëri demokratike që respekton dhe mbron të drejtat e njeriut:.... si parim fundamental duhet ta njohë supremacinë e ligjit”³Kështu duhet të veprojmë edhe ne në Kosovë.

TREGUESIT

1. Numri i ligjeve të miratuara dhe shkalla e përputhjes së tyre me vendet e UE-së.
2. Numri i raportimeve për zbatimin e ligjeve sipas fushave dhe sektorëve të ndryshëm të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës brenda një viti.
3. Deri në vitin 2017, pesë raporte dyvjeçare të hartuara për zbatimin e ligjeve në Kosovë, në fushën e respektimit, mbrojtjes dhe të avancimit të gjendjes së të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.
4. Tri vlerësime të performancës së institucioneve dhe të OJQ-ve për *respektimin, mbrojtjen dhe avancimin e gjendjes së të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë.*
5. *Numri i planeve të veprimit të institucioneve dhe të OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (gjqytarëve, prokurorëve, shtëpive ndëshkimore).*
6. Ekzistimi i planeve të bashkëpunimit ndërmjet organeve të gjyqësisë, prokurorisë dhe të ekzekutivit lidhur me plotësimin, nxjerrjen dhe vlerësimin e cilësisë, zbatueshmërisë dhe të efikasitetit të Kornizës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

MASAT

Masa 4.2.1.1. Rishikimi i ligjeve ekzistuese dhe hartimi i ligjeve të reja.

Përshkrimi:

- Rishikimi dhe harmonizimi i ligjeve dhe akteve nënligjore (rregulloreve, protokolleve, deklaratave) e harmonizimi i tyre me kornizën ligjore të UE-së.
- Ndryshimi dhe plotësimi i infrastrukturës ligjore me saktësimin e kompetencave dhe të përgjegjësisive.
- Valorizimi financiar i zbatimit të ligjeve dhe ligjeve të reja.
- Hartimi i ligjeve të reja si: Ligji për mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave të fëmijës; Ligji për ndalimin e shitjes së duhanit për të rinj nën moshën 18 vjeçare; Ligji për legalizimin e prostitucionit; Ligji për parandalimin dhe dënimin e krimit të trafikimit të qenieve njerëzore; Ligji për ndalimin e përdorimit të të gjitha formave të torturës, përcmimit, të shkeljes dhe nëpërkëmbjes së dinjitetit njerëzor; Ligji për paketën e treguesve cilësorë dhe sasiorë të të drejtave të fëmijës dhe të njeriut.

Masa 4.2.1.2. Edukimi dhe aftësimi për zbatimin e ligjshmërisë.

Përshkrimi:

- Edukimi i të rinjve për rolin dhe rëndësinë e ligjeve dhe të zbatimit konsekuent të ligjeve (ligjërata, vizita në seanca gjyqësore, simulimi i seancave gjyqësore.
- Ndërtimi i kapaciteteve monitoruese për vlerësimin e zbatimit të ligjeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.
- Publikimi i materialeve dhe doracakëve për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.

- Organizimi i trajnimeve për gazetarët, organizimi i hulumtimeve dhe vlerësimeve të shpejta për zbatimin e ligjeve.
- Organizimi i trajnimeve dhe informimi sistematik i qytetarëve për të gjitha ligjet e reja, të cilat lidhen me të drejtat e tyre.

Masa 4.2.1.3. Ndërtimi i një sistemi për menaxhimin e të dhënave për të gjitha rastet e moszbatimit të ligjit, që lidhen me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.

Përshkrimi

- Formimi i INDOK _ sistemit për shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës në Kosovë për shkak të mos zbatimit të ligjit (Ministria e Drejtësisë - MD).
- Zhvillimi i softuerit të avancuar për përpunimin e të dhënave.
- Instalimi i infrastrukturës fizike në nivel komune, rajoni, të ministrive përkatëse dhe të MD-së.
- Publikimi i të dhënave në “Panairin vjetor” të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.

Masa 4.2.1.4. Përcaktimi dhe zbatimi i procedurave për vlerësimin dhe vetëvlerësimin e performancave të institucioneve dhe të organizatave, që merren me të drejtat e fëmijës.

Përshkrimi

- Ndërtimi i kapaciteteve për vlerësim dhe vetëvlerësim të performancës së institucioneve, që duhet të zbatojnë ligjet në fushën e të drejtave të fëmijës.
- Hartimi i metodologjisë për vlerësim dhe vetëvlerësim të performancës në fushën e të drejtave të fëmijës.
- Bashkëpunimi i institucioneve dhe i organizatave, që zbatojnë ligjet në fushën e të drejtave të fëmijës me qëllim të këmbimit të përvojave në funksion të vlerësimit dhe të vetëvlerësimit të performancave të institucioneve.

SUPOZIMET KRITIKE

Mosgjdhja e statusit politik të Kosovës krijon mundësi për mosfunksionimin e sundimit të ligjit. Pasojë e tërë kësaj, është përkeqësimi i gjendjes së të drejtave të njeriut, pasiguria, pabarazia, mungesa e drejtësisë sociale, ngecja e proceseve demokratike, shtimi i varfërisë etj. Të gjitha këto do të kenë implikime të shumëfishta në respektimin, mbrojtjen dhe avancimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë në përgjithësi, dhe të fëmijës në veçanti.

OBJEKTIVA 2.

4.2.2. Sistem i krijuar funksional i mbrojtjes shëndetësore dhe i përkujdesjes për nënat dhe fëmijët.

Në mbështetje të nenit 24 të KDF-së, Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet shëndetësore në bashkëpunim me sektorët tjerë, shoqërinë civile dhe OJQ-të e kanë për detyrë të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme:

- që të zvogëlohet vdekshmëria e nënave shtatzëna dhe fëmijëve;

- të sigurohet ndihma mjekësore dhe mbrojtja shëndetësore për të gjithë fëmijët e Kosovës, me theks të veçantë në mbrojtjen primare shëndetësore;
- të merren masa preventive për parandalimin e sëmundjeve të fëmijëve dhe të ushqyerit keq të tyre;
- të sigurohet mbrojtja paranatale dhe pasnatale për nënat;
- të sigurohen dhe nxiten të gjitha segmentet e shoqërisë dhe veçmas prindërit e fëmijët që të jenë të informuar dhe të kenë qasje në arsim dhe të inkurajohen që të kenë njohuritë themelore për shëndetin dhe ushqimin e fëmijëve, si dhe të njohin përparësitë e ushqimit me qumësht të nënës.
- Të vendoset një bashkëpunim ndërkombëtar.

TREGUESIT

1. Të dhënat vjetore dhe statistikat e sakta për zvogëlimin e mortalitetit të nënave shtatzëna dhe të fëmijëve;
2. 90% të grave shtatzëna të viseve rurale dhe urbane i bëjnë së paku tri vizita antenatale në klinikat gjegjëse për shtatzëni;
3. Numri mesatar i shfrytëzimi të ultrazërit gjatë shtatzënisë;
4. Ekzistojnë procedurat dhe sistemi i kontrollit antenatal të grave shtatzëna.

MASAT

Masa 4.2.2.1. Rishikimi i Ligjit për mbrojtjen shëndetësore nga aspekti i mbrojtjes së nënave.

Përshkrimi:

Rishikimi i Ligjit të bëhet nga aspekti i rregullimit të çështjeve, që kanë të bëjnë me detyrimet që lidhen me mbrojtjen e nënave, parandalimin e sëmundjeve të fëmijës, zvogëlimin e mortalitetit të fëmijëve dhe të nënave, vendosjen e procedurave dhe standardeve për mbikëqyrje. Gjithashtu të bëhet valorizimi financiar për zbatimin e këtyre dispozitave të ligjit të amendamentuar.

Masa 4.2.2.2. Të zhvillohen procedura dhe sisteme të mbikëqyrjes sistematike antenatale.

Përshkrimi

Sipas hulumtimeve të bëra të prezantuara nga studimet e shumta del përfundimi se shumë rrallë gratë shtatzëna kontrollohen ose mbikëqyren nga ana e mjekëve familjarë apo nga motrat akusherike. Kjo ndodh për shkak se personeli mjekësor nuk është i trajnuar sa duhet në sistemin e mbrojtjes parësore shëndetësore.

Masa 4.2.2.3. Decentralizimi i sistemit shëndetësor në Kosovë dhe integrimi i sistemit paralel shëndetësor serb në sistemin shëndetësor të Kosovës.

Përshkrimi

Gjatë hulumtimit të të drejtave të fëmijës në aspektin dhe mbrojtjen shëndetësore kemi konstatuar se sistemi shëndetësor është shumë i centralizuar dhe si i tillë paraqet

“fyt” të ngushtë për përkujdesje dhe mbrojtje shëndetësore të nënave shtatzëna, prandaj duhet decentralizuar sistemin e tashëm. Në Kosovë veprojnë dy sisteme paralele shëndetësore, ai serb, që qeveriset nga Beogradi dhe i Kosovës, që qeveriset nga UNMIKU dhe IPVQ-të. Me decentralizimin dhe me vendosjen e kontakteve do të bëhej një integrim natyror i këtyre dy sistemeve në interes të qytetarëve dhe të fëmijëve të Kosovës.

Masa 4.2.2.4 . Të hartohen standarde të avancuara teknike – medicinale dhe shërbyese sanitare, që garantojnë cilësi të lartë të shërbimeve në klinikat private.

Përshkrimi

Monitorimi i shtypit, studimet meta-analitike, studimi i raporteve të organizatave të ndryshme joqeveritare, të OBSH-së, UNICEF-it etj, tregojnë se ekzistojnë tregues që cilësia e shërbimeve në klinikat private është shumë më e dobët se në sektorin publik. Kjo sidomos ka të bëjë me dhënien e këshillave, që lidhen me ushqimin e nënave, rëndësinë e ushqimit të fëmijëve nga qumështi i nënës, pastaj dëmi që shkakton pirja e duhanit, përdorimi i disa barnave dhe alkooli.

Masa 4.2.2.5. Zvogëlimi i vdekshmërisë së fëmijëve.

Përshkrimi

Vdekja perinatale dhe neonatale në Kosovë, sipas të gjitha raportimeve dhe studimeve është shumë e lartë. Faktorët e shumtë kanë ndikuar që kjo të ndodhë si pasojë e peshës së ultë me rastin e lindjes, lindjes së parakohshme, asfiksionit perinatale dhe pirjes së duhanit. Për të zvogëluar vdekshmërinë duhet përkujdesje për shëndetin e nënave dhe arsimimi i tyre. Ushqimi i fëmijëve deri në gjashtë muaj duhet të jetë ekskluzivisht qumësht i nënës.

Masa 4.2.2.6. Të krijohet një sistem funksional i mobilizimit, lajmërimit dhe i raportimit e mbikëqyrjes për imunizimin, veçmas për efektet e përcjelljes, të cilat e ndjekin imunizimin për sëmundjet e caktuara siç është fruthi.

Përshkrimi

Mungesa e të dhënave demografike dhe qarkullimi jo i mirë i rrjedhës së informacioneve nëpër nivelet e ndryshme, vështirësojnë planifikimin e imunizimit (sidomos të fëmijëve të komunitetit RAE), sigurimin e sistemit të mbledhjes dhe të përhapjes së informacionit për imunizimin: publikime periodike, raportime, përkrahje e mëtejme e Programit të Zgjeruar të imunizimit.

Masa 4.2.2.7 Hartimi i një sistemi funksional të avokimit për mbrojtjen shëndetësore të fëmijëve.

Përshkrimi: Krijimi i një sistemi funksional për zbulimin e hershëm, trajtimin dhe përmirësimin e anomalive e ngecjeve psikike – fizike të fëmijëve; Rishikimi i kurrikulëve, teksteve shkollore nga këndi i mbrojtjes dhe edukimit shëndetësor; organizimi i fushatave, ligjëratave, debateve televizive etj.

Masa 4.2.2.8. Krijimi i një sistemi për zbulimin e hershëm, trajtimin dhe përmirësimin e anomalive dhe ngecjeve në zhvillimin psikik dhe fizik.

Përshkrimi:

Në nivel qendror, rajonal dhe lokal të formohen ekipet për identifikimin dhe zhvillimin e hershëm të anomalive dhe të ngecjeve në zhvillimin psikik dhe fizik.

SUPOZIMET KRITIKE

Gjendja e Shëndetësisë dhe e shëndetit publik në Kosovë është përkeqësuar. Qytetarët e Kosovës kanë jetëgjatësinë mesatare më të shkurtër në Evropë. Duhet ndërmarrë reforma të thella në shëndetësinë e Kosovës. Pa ndryshime të këtilla masat e propozuara mund të mos realizohen.

OBJEKTIVA 3

4.2.3. Sistemi i krijuar efikas dhe efektiv i zhvillimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme

“Investo në fëmijëri të hershme që të kursesh më vonë”.

Në të gjitha studimet më të reja që merren me zhvillimin njerëzor dhe kapitalin social, trajtohen çështja e demokracisë, zgjidhja e problemeve të varfërisë dhe eliminimi i urrejtjeve ndëretnike në shoqëritë, që kanë kaluar nëpërmjet konflikteve etnike dhe fetare. Me këto studime arrihet në përfundim se çështja e parë që duhet të bëhet për tejkalimin e qëndrueshëm të të gjitha problemeve, është investimi në fëmijëri të hershme. Për këtë arsye investimi në fëmijëri të hershme konsiderohet si kursimi më racional për të ardhmen.

TREGUESIT

1. Shkalla e braktisjes së të porsalindurve të zvogëlohet në vit për 10%.
2. Shkalla e ushqimit të fëmijëve me qumësht të nënës të shtohet në vit për 5 %.
3. Deri në vitin 2017, të gjitha amvisëritë të lidhen me sistemin e ujësjellësit dhe të kanalizimit.
4. Deri në vitin 2015, asnjë fëmijë në Kosovë të mos jetë i përfshirë me sëmundjen e TBC-së.
5. Deri në vitin 2009, të ndalet trendi i numrit të madh të të shkurorëzuarve.
6. Deri në vitin 2017, të dyfishohet numri i shtëpive për përkujdesjen e fëmijëve pa prindër, për fëmijët e braktisur.
7. Deri në vitin 2017, në të gjitha komunat e Kosovës të themelohen çerdhet për përkujdesje sociale dhe shëndetësore.
8. Deri në vitin 2017, të gjithë fëmijët e grup moshës 3-6 vjeç. të përfshihen në një nga shumë programet alternative të edukimit parashkollor.
9. Deri në vitin 2017, i gjithë personeli që punon në edukimin parashkollor të ketë të kryer Fakultetin e Mësuesisë.
10. Deri në vitin 2017, të gjithë edukatorët të jenë të aftësuar për të punuar me metodologjitë bashkëkohore të mësimdhënies.
11. Numri i teksteve, librave manualeve për fëmijë parashkollor të dyfishohet.

MASAT

Masa 4.2.3.1. Krijimi i një sistemi të vetëdijesimit të të rinjve për përgjegjësinë prindërore.

Përshkrimi:

Nga viti 1999 me shturjen e familjes patriarkale dhe me shtimin e varfërisë për shkak të rrënimëve e shkatërrimeve të mëdha, arsimimit të pamjaftueshëm të të rinjve, vazhdimisht është në rritje fenomeni i braktisjes së fëmijëve. Për këtë qëllim shoqëria civile, institucionet arsimore, qeveria, shërbimet dhe institucionet shëndetësore duhet të punojnë që fenomeni i braktisjes të shikohet ndryshe dhe trajtimi i këtyre fëmijëve të jetë human dhe me përkujdesjen e duhur dhe të nevojshme.

Masa: 4.2.3.2. Krijimi i sistemit të vetëdijesimit dhe arsimimit të prindërve, për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijëve, në fëmijëri të hershme.

Përshkrimi:

Në studimet dhe matjet antropometrike është konstatuar se në dekadat e fundit, fëmijët e Kosovës, për shkak të të ushqyerit jo të rregullt, kanë gjasa që më shpejtë të vdesin dhe të jenë me peshë e gjatësi më të vogël. Të gjitha këto janë si pasojë e varfërisë, arsimimit të pamjaftueshëm të nënave të reja krahasuar me moshataret e rajonit. Në hulumtime është konstatuar mungesa e vitaminës A (te 36% të fëmijëve nën moshën pesëvjeçare me një prevalencë më të madhe në vendbanimet rurale (se në vendbanimet urbane 32%). Po ashtu, në këtë hulumtim të fëmijët nën moshën 2 vjeçare është hetuar mungesa e vitaminës A të në më pak se 1 % e fëmijëve të kontrolluar. Është e ditur se mungesa e vitaminës A, dobëson sistemin imunologjik duke zvogëluar rezistencën e fëmijëve ndaj diarresë. Në hulumtime është konstatuar mungesa e jodit, që shkakton dëmtime në zhvillimin mental e fizik si dhe anomali kongjenitale (prevalenca e gushës së fëmijëve në moshën 5 vjeçare në Kosovë është rreth 9 %, ndërsa në Serbi është 6%, Maqedoni 7 %, Kroaci 1 %).

Masa 4.2.3.3. Ndërmarrja e masave për sigurimin e ujit të pastër nga aspekti kimik dhe bakteriologjik.

Përshkrimi

Në shumë hulumtime është konstatuar se një numër i madh i sëmundjeve dhe vdekjeve të fëmijëve janë si rezultat i ujit të ndotur, të përzier me derivate të naftës, me ujëra të zeza etj. Nga uji i papastër në vitin 1999, mijëra fëmijë janë përfshirë nga: Hepatiti A, Tularemia, Meningjiti, Diarreja etj. Nga të gjitha mostrat e hulumtuara, është konstatuar se 82.5 % e ujit në Kosovë, bakteriologjikisht ka qenë i kontaminuar, ndërsa në aspektin kimik 52.5%.

Masa 4.2.3.4. Krijimi i një sistemi efikas për luftimin e sëmundjes së TBC-së në fëmijërinë e hershme

Përshkrimi

Kosova trajtohet si vend endemik për tuberkulozë. Nga vitet e '90-ta e këndeje për shkak të përkeqësimit të kushteve ekonomike, higjienike dhe sanitare, sëmundja e tuberkulozit në Kosovë pandërprerë shënon rritje.

Masa 4.2.3.5. Zhvillimi i një sistemi funksional shëndetësor për parandalimin e sëmundjeve akute të frymëmarrjes (SAF)

Përshkrimi:

Sëmundjet akute të frymëmarrjes janë ndër shkaktarët kryesorë të vdekjes së fëmijës. Këto sëmundje paraqiten si rezultat i mjedisit të papastër, ajrit, ujit, tokës si dhe kushteve të këqija sanitare higjienike. Fushatat e organizuara për shtimin e vetëdijes për mbrojtjen dhe përparimin e mjedisit, mbikëqyrjen e kushteve sanitare higjienike, janë faktorë me rëndësi për mbrojtjen e mjedisit të Komunitetit RAE në Kampin e Zhitkovcit në Mitrovicë. Ata jetojnë në një zonë të kontaminuar, prandaj është e domosdoshme zhvendosja e tyre dhe kurimi i fëmijëve të atakuar nga përqendrimi i madh i plumbit në gjak.

Masa 4.2.3.6. Rritja e vetëdijesimit të prindërve për rolin dhe rëndësinë që ka familja për zhvillimin e fëmijëve në fëmijërinë e hershme.

Përshkrimi:

Pas luftës për shkak të rrethanave të ndryshme, procesi i shkurorëzimeve të bashkëshortëve të rinj është në rritje enorme. Për këtë arsye, fëmijët e tyre përjetojnë stres dhe ankth të madh gjatë procesit të shkurorëzimit, andaj duhet formuar dhe stimuluar formimi i këshillimoreve për prindër të rinj në mënyrë që të zvogëlohet numri i shkurorëzimeve. Po ashtu prindërit para dhe gjatë shkurorëzimeve duhet të kenë kujdes si sillen në mënyrë që fëmijët të mos përjetojnë trauma dhe goditje të rënda psikike, që mund mbeten të përhershme për zhvillimin e tyre psikik dhe fizik. Duhet hartuar programi i arsimimit dhe edukimit familjar për rolin e ri të familjes në shekullin XXI.

Masa 4.2.3.7. Hartimi i programeve për përfshirjen e të gjithë fëmijëve për një nga format e zhvillimit dhe të edukimit në fëmijërinë e hershme.

Përshkrimi:

Shkalla e përfshirjes së fëmijëve në një nga format e edukimit dhe të zhvillimit të hershëm, është një kërkesë shumë urgjente, sepse moshë parashkollorë është moshë me zhvillimin më të hovshëm dhe më dinamik në jetën e njeriut. Studimet kanë treguar se fëmijët që kur janë më të vegjël kanë aftësi dhe zotësi për të nxënë. Hulumtimet tregojnë se fëmijët e përfshirë në edukim parashkollor përafërsisht 30% e tyre arrijnë sukses më të lartë se moshatarët e tyre të pa përfshirë në këtë proces. Përfshirja e fëmijëve në edukim parashkollor, ndihmon zhvillimin e tyre social, psikik, mental dhe fizik. Andaj duhet inkurajuar format e ndryshme të përfshirjes së fëmijëve në edukimin parashkollor siç janë: Qendra me Bazë në Komunitet dhe Edukimi Institucional Parashkollor Privat me të gjitha standardet e nevojshme dhe të plotësuara.

Masa 4.2.3.8. Monitorimi, inspektimi, vlerësimi dhe raportimi për zbatimin e ligjit për edukimin parashkollor.

Përshkrimi

Inspektorët e arsimit duhet t'i nënshtrohen një trajnimit të veçantë për monitorimin dhe zbatimin e Ligjit për edukimin parashkollor. Një trajnim të këtillë duhet ta bëjnë edhe drejtorët e institucioneve parashkollore, zyrtarët e lartë të arsimit në Zyrat Rajonale, këshilltarët e arsimit në Drejtoritë Komunale të arsimit etj. Për çdo vit duhet të përgatitet një raport i detajuar për zbatimin e ligjit në të gjitha institucionet e edukimit parashkollor. Në të gjitha komunat e vendbanimet rurale të hapen dhe krijohen mundësi për përfshirjen e fëmijëve në edukim parashkollor nga mosha 3-6 vjeçare.

Masa 4.2.3.9 Sigurimi i një personeli të kualifikuar edukativ dhe qeverisës me licencë të Fakultetit të Edukimit apo të Fakultetit Filologjik - dega e Pedagogjisë.

Përshkrimi

Struktura kualifikuese e personelit të tashëm, që punon në edukimin parashkollor nuk është në përputhje me kërkesat e shekullit XXI dhe Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit. Deri në vitin 2017, i gjithë personeli mësimor edukativ përmes formave të ndryshme të studimeve duke përfshirë edhe studimin në distancë duhet të kenë licencën e pranuar, e cila lëshohet nga Fakulteti i Edukimit dhe pranohet nga MASHT-i. Secili student që përfundon Fakultetin e Edukimit duhet të marrë një Program trajnimit për shërbim. Programi i trajnimit për shërbim ka të bëjë me mësimdhënësit fillestarë-praktikantë.

Masa 4.2.3.10. Krijimi i një sistemi funksional të përparimit në karrierë.

Përshkrimi:

Me qëllim të shndërrimit të institucioneve në organizata të fuqishme të prodhimit të dijeve duhet hartuar një sistem funksional të përparimit në karrierë duke i përfshirë të gjithë mësimdhënësit në programe të akredituara të zhvillimit profesional (për profesione-lëmenj të ngushtë, p.sh. gjuhë, muzikë-logotrop) dhe për zejen e mësimdhënies dhe të nxëniet (pedotrop), në mënyrë që secili mësimdhënës apo personel edukativ të ketë një "lokus" të brendshëm. Duke i arritur standardet më parë të caktuara do të përparojnë në karrierë: *edukator fillestar, edukator, edukator i avancuar, edukator mentor dhe edukator i merituar*

Me qëllim që fëmijët të vendosen në qendër të edukimit dhe të arsimit, personeli arsimor në edukimin parashkollor duhet të aftësohet për zbatimin e metodologjive më të reja të mësimdhënies: Hap pas Hapi, Metodologjitë e Zhvillimit të Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit, Mësimdhënia me hapa të vegjël, Mësimdhënia ndërmjetësuese, problemore, ekzemplare, Mësimdhënia dhe të nxëniet duke zhvilluar dhe zbatuar 12 shprehitë e të menduarit. Mësimdhënësit dhe personeli tjetër edukativ për çdo vit duhet t'i nënshtrohet një kontrolli detaj shëndetësor. Në institucione të fuqizohet konsulenca me pedagogë, bibliotekarë, psikologë, mjekë dhe stomatologë.

Masa 4.2.3.11. Krijimi i një fondi librar dhe i një sistemi koherent të burimeve të ndryshme të informacionit.

Përshkrimi

Tani në edukimin parashkollor në të gjitha gjuhët e bashkësive etnike ka një fond të vogël librash, doracakë, enciklopedi, fletore të punës, lodra, rekuizita dhe mjete të tjera mësimore edukative. Duhet gjetur mundësi dhe zgjidhje praktike që ky fond të pasurohet. Në institucionet parashkollore do të duhej të fillojë mësimi i gjuhës angleze dhe funksionimi i punës në internet.

Masa 4.2.3.12. Krijimi i sistemit të monitorimit e vlerësimit të zbatimit të kurrikulit dhe standardeve të miratuara.

Përshkrimi:

Në këtë vit ka filluar zbatimi i kurrikulit të ri për edukimin parashkollor. Në vitin 2007, duhet të bëhet monitorimi, hulumtimi dhe vlerësimi i zbatimit të kurrikulave e standardeve të miratuara. Pas monitorimit, do të duhej të hartohej një raport i detajuar për arritjet në zbatimin e kurrikulit të ri dhe të standardeve. Mbi konstatimet e bëra duhet të bëhen ndryshimet dhe plotësimet e nevojshme të kurrikulave.

OBJEKTIVA 4.

MASAT

4.4. Sistemi efikas dhe efektiv i edukimit dhe i arsimit të fëmijëve të moshës 6 – 18 vjeçare.

“Jeto sikur do të vdesësh nesër. Mëso sikur do të jetosh përgjithmonë”.

Anonim

E drejta në arsim është e drejtë e garantuar me DUDNj. Në Nenin 26 të kësaj deklarate, në mes tjerash thuhet: “Çdo njeri ka të drejtën e arsimit. Arsimi duhet të jetë falas, të paktën për sa i përket arsimit fillor dhe themelor. Arsimi duhet të mundësojë lulëzimin e plotë të personalitetit njerëzor dhe forcimin e respektit për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Ai duhet të zhvillojë mirëkuptimin, tolerancën dhe miqësinë midis të gjitha kombeve dhe të gjitha grupeve raciale ose fetare si dhe të ndihmojë zhvillimin e veprimtarive të Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes”.

Në KDF në Nenin 28 thuhet “Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për arsim me qëllim që kjo e drejtë të arrihet hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta në mënyra të veçanta ato:

- a) bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;
- b) inkurajojnë zhvillimin e formave të ndryshme të arsimit të mesëm duke përfshirë edhe arsimin e përgjithshëm dhe profesional, i bëjnë ato të hapura e të mundshme për çdo fëmijë dhe marrin masa të përshtatshme, si vendosja e arsimit falas dhe dhënia e një ndihme financiare në rast nevojë;

c) sigurojnë të gjithë arsimin e lartë, sipas aftësive të secilit me të gjitha mjetet e përshtatshme:

ç) bëjnë të mundshëm dhe të arritshëm për çdo fëmijë informacionin dhe orientimin shkollor profesional;

d.) marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës;

Në pikën 2 të këtij Neni thuhet: “Shtetet palë marrin të gjitha masat e përshtatshme dhe të nevojshme për të siguruar që disiplina shkollore të zbatohet në mënyrë të pajtueshme me dinjitetin njerëzor të fëmijës dhe në përputhje me këtë konventë”

Në nenin 29 të KDF-së thuhet:” Shtetet palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:

a) Zhvillimin e potencialit të plotë të personalitetit, të dhuntive dhe të aftësive mendore e fizike të fëmijës”...

Shumë të drejta politike dhe civile siç është edhe e drejta për informim, liria e të shprehurit, e drejta në zhvillim, nuk mund të realizohen pa plotësimin e të drejtës në arsim. Mohimi dhe shkelja e të drejtës në arsimim dëmton aftësinë e fëmijëve të zhvillojnë personalitetet e tyre, të mbështesin dhe ta mbrojnë vetveten dhe familjet e tyre si dhe të marrin pjesë në jetën shoqërore, arsimore, politike, ekonomike kulturore dhe zbavitëse. Në shkallën e gjerë të shoqërisë, mohimi i së drejtës në arsimim dëmton çështjen e demokracisë, të përparimit shoqëror, cenon paqen ndërkombëtare dhe sigurinë njerëzore.

Standardet që do të duhen të arrihen për të gëzuar të drejtën në arsimim janë:

- arsimimi i detyruar për të gjithë fëmijët e moshës 6 – 15 vjeçare;
- qasje e plotë në arsim të lartë të mesëm për të gjithë fëmijët e moshës 15 –18 vjeçe;
- arsim i lartë për të gjithë, varësisht nga mundësitë dhe kapacitetet e tyre mentale dhe fizike;
- sigurimi i arsimimit themelor për të gjithë ata që nuk e kanë kryer arsimin e detyruar (mosha 10 –18 vjeçe);
- eliminimi i analfabetizmit dhe i injorancës (analfabetizmit funksional).

TREGUESIT

1. Ekzistimi i kornizës së plotë legislative për të gjitha aspektet e arsimit parauniversitar dhe i krahasueshëm me vendet e UE-së.
2. Ekzistimi i raporteve vjetore për zbatimin e ligjeve në arsim.
3. Sistemi për Menaxhimin e Informacionit në funksion të arsimit.
4. Ekzistimi i Strategjisë nacionale për arsimin parauniversitar.
5. Ekzistimi i planeve të veprimit për zbatimin e Strategjisë nacionale.
6. Ekzistimi i një sistemi të zbatueshëm për monitorimin dhe përcjelljen e strategjisë.
7. Të gjithë fëmijët e moshës 6 –18 pa dallim etnie, feje, gjinie, shtrese sociale dhe ekonomike të përfshirë në arsimin fillor dhe të mesëm të ulët.
8. I gjithë personeli mësimor edukativ deri në vitin 2017, të jetë me kualifikim përkatës (Fakultetin e Edukimit të përfunduar apo fakultetet tjera gjegjëse për zhvillimin e mësimin).
9. Deri në vitin 2017, të gjithë mësimdhënësit të jenë në shërbim të arsimit universitar dhe të aftësuar për zbatimin e metodologjive e strategjive të reja mësimore për vendosjen e të gjithë nxënësve në qendër të mësimdhënies.

10. Në të gjitha shkollat e Kosovës deri në vitin 2017, të jenë të formuara shërbimet profesionale pedagogjike, shërbimet mjekësore, bibliotekare,- mediatekare; shërbimet e konsulencës dhe shërbimet tjera fasilituese.
11. Në të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar të ekzistojë një mjedis i përshtatshëm për mësimdhënie dhe të nxëniet e suksesshëm (në të cilat mësimi zhvillohet në më së shumti në dy ndërrime).
12. Deri në vitin 2010 të jenë hartuar standardet, që garantojnë efikasitetet dhe efektivitetet të lartë të arsimit parauniversitar.
13. Në arsimin parauniversitar të gjithë nxënësit do të përparojnë pandërprerë më shumë se sa pritjet nga ata me rastin e regjistrimit (në të gjitha shkollat dhe tek të gjithë nxënësit do të krijohen extra-vlera).
14. Të gjithë nxënësit, që e regjistrojnë klasën e parë në vitin shkollor 2007/8, do të jenë në gjendje të shkruajnë dhe të flasin pa pengesa në gjuhën amtare. Do të mësojnë edhe gjuhën angleze dhe gjuhën e mjedisit.
15. Në vitin 2015, nxënësit e Kosovës, në programin PISA do të renditen në mesin e 15 vendeve të para.
16. Në “Maturën e Vogël” 90% të nxënësve do të kalojnë në afatin e parë.
17. Në Maturën e “Madhe” 80 % e nxënësve do të kalojnë në afatin e parë.
18. Deri në vitin 2017, nuk do të ekzistojë delikuenca nga të miturit, por ajo mund të jetë e rastësishme.
19. Deri në vitin 2008, sistemi i arsimit të Kosovës do të jetë i integruar dhe në të gjithë qytetarët e saj, të cilët do të edukohen dhe arsimohen me një program multi dhe ndërkulturor.
20. Deri në vitin 2008, do të ekzistojë një raport i detajuar për shkallën, efektivitetin dhe efikasitetin e sistemit të arsimit.
21. Duke filluar nga viti, 2008 MASHT-i do të përgatisë raportet e detajuara për efikasitetin dhe efektivitetin e Sistemit të Arsimit në Kosovë.

MASAT

Masa 4.2.4.1. Monitorimi, inspektimi dhe vlerësimi i gjendjes së Kornizës së tashme ligjore në arsim dhe krahasimi i saj me vendet e UE-së.

Përshkrimi:

Korniza ligjore e deritanishme e arsimit parauniversitar, është hartuar me një qasje fragmentare pa diskutime publike dhe pa një pjesëmarrje të gjerë të opinionit publik dhe të qytetarëve, interesat vitale të të cilëve përcaktohen me këto ligje. Ç’ është e vërteta, nëse nisemi nga referencat e tyre, që u bëhen standardeve dhe instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës, në to, nuk ka fare vërejtje. Mirëpo, shkalla e aspiracionit, për një avancim dhe zhvillim të përshpejtuar të procesit të ngritjes së efektivitetit dhe të efikasitetit, është e ulët, jo sfiduese dhe jo mobilizuese. Për shkak të qasjeve fragmentare në këto ligje ka: kolizione, përzierje të kompetencave, paqartësi, gjë që ka bërë që këto ligje të jenë në masë të konsideruar të pazbatueshme. Në anën tjetër, në këto ligje nuk është bërë valorizimi financiar apo nuk është përcaktuar kostoja e zbatimit të tyre, andaj edhe pjesa dërmuese e tyre nuk mund të realizohen për këtë shkak apo pse janë paraparë, gjëra që nuk bazohen në analiza dhe vlerësime të sakta. Të gjitha këto kanë bërë që ligjet të mos jenë në funksion të krijimit të shtetit ligjor, por të përdorimit të tyre për interesa që godasin shtetin ligjor dhe sundimin e ligjit, zvogëlojnë përgjegjësinë publike, nxisin abuzimet

dhe keqpërdorimet e kriminalitetin. Për këtë arsye gjatë vitit 2007, duhet formuar një trup kompetitiv, që do të koordinojë monitorimin e zbatimit të ligjeve nen për nen, do të bëjë vlerësimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të tyre dhe krahasimin e këtyre ligjeve me ligjet e UE-së.

Mbi këto konstatime duhet të fillojë ndryshimi, plotësimi, përmirësimi dhe përafrimi i tyre me kornizën ligjore të UN. Procesi i amendamentimit, plotësimit, ndryshimit dhe harmonizimit me Ligjet e UE-së, duhet të përfundojë në vitin 2008

Masa 4.2.4.2. Zbatimi i legjislacionit.

Përshkrimi

Inspektorët e arsimit dhe inspektorët sanitarë brenda vitit 2007 do të bëjnë një monitorim dhe vlerësim të të gjitha ligjeve nen për nen në institucionet e arsimit parauniversitar.

Monitorimit dhe vlerësimit do t'i paraprijë një trajnim pesë ditor me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve për përdorimin e instrumenteve dhe të mjeteve të monitorimit dhe të vlerësimit.

Për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjeve në arsimin parauniversitar që në fillim të vitit 2007 do të hartohen planet e veprimit dhe kalendari i inspektimeve.

Në fillim të vitit 2008, do të prezantohet Raporti i detajuar për monitorimin dhe zbatimin e ligjeve në arsimin parauniversitar.

Masa 4.2.4.3 Krahasimi i ligjeve të arsimit parauniversitar me Ligjet e disa shteteve reprezentative të UE-së.

Përshkrimi:

Identifikimi i shteteve të UE-së, me të cilat struktura e sistemit parauniversitar është e përafërt.

Analiza dhe krahasimi i ligjeve. Raportimi për shkallën e pajtueshmërisë.

Ndryshimi dhe plotësimi i ligjeve të Kosovës me qëllim të avancimit të tyre (2008).

Masa 4.2.4.4. Edukimi i nxënësve për zbatimin e ligjeve dhe të shtetit ligjor.

Përshkrimi:

Ndërtimi i kapaciteteve të mësimdhënësve të Edukatës shoqërore dhe qytetare për legjislaturë dhe zbatimin e rolit dhe ligjit për krijimin e shtetit ligjor (përgatitja e mësimdhënësve trajnerë për legjislacion)

Trajnimi i të gjithë mësimdhënësve të Edukatës shoqërore për legjislaturën arsimore dhe të këshilltarëve për të drejtat e fëmijës.

Organizimi i tryezave të rumbullakëta dhe i debateve në komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës; simulimi i seancave gjyqësore, vizita në seanca gjyqësore, organizimi i ligjëratave nga gjykatësit, prokurorët dhe avokatët.

Masa:4.2.4.5. Decentralizimi i vendimmarrjes me qëllim të shtimit të autonomisë së shkollës.

Përshkrimi:

Me ligjin ekzistues për arsimin fillor dhe të mesëm është bërë një përqendrim shumë i madh i kompetencave në vendimmarrje në nivelin qendror. Përqendrimi i kompetencave në MASHT, ka bërë që procesi i monitorimit dhe i vlerësimit të efikasitetit dhe efektivitetit të mos realizohet në masën e duhur. Shkolla dhe komuniteti nuk kanë ndikim në përzgjedhjen e organeve qeverisëse. Drejtorët e shkollave nuk mund të kenë ndikim në përzgjedhjen e drejtorëve. Ata nuk kanë xhirollogari, andaj për të blerë gjërat më themelore higjienike - sanitare për mirëmbajtjen e shkollës duhet të shtrojnë kërkesa në DKA. Pasojat e një veprimi të këtillë janë: mosmirëmbajtja e higjienës në shkolla, ulja e përgjegjësisë, mungesa e llogaridhënies dhe krijimi i një mjedisi të papërshtatshëm për të nxënë.

Masa 4.2.4.6. Krijimi i Institutit Rajonal për të Drejtat e Fëmijës (IRDF).

Përshkrimi:

Ballkani përfshirë këtu edhe Kosovën, një kohë të gjatë, ka qenë rajon ku kanë ndodhur shkelje të rënda të të drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Recidivat e së kaluarës në formën e urrejtjes, ksenofobisë, racizmit ende janë në kokat dhe mendjet e njerëzve të rritur, një pjesë e të cilëve për fat të keq ende janë në mundësi të ndër marrin veprime të kobshme. Për të para penguar që njerëzit e këtillë të arrijnë në pozita të tilla duhet ngritur vetëdijen qytetare dhe rolin e rëndësishëm të arsimit. Forma më e mirë do të ishte themelimi i një Instituti rajonal i cili do të hulumtonte shkeljen e të drejtave të njeriut, do të organizonte fushata për ngritjen e rolit irenik të arsimit (pika ç, e Nenit 29) dhe do të zbatonte në jetë, pikën 3, të Nenit 29 të KDF-së. Në IRDF do të krijohet Qendra kryesore për Menaxhimin e Informacioneve për të Drejtat e Fëmijës (QMIDF) në bashkëpunim me Qendrat e këtilla që do të funksiononin në MASHT, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë për Mbrojtjen e Ambientit, Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Masa 4.2.4.7. Hartimi i politikave të përshtatshme për përfshirje të plotë të të gjithë fëmijëve, pavarësisht nga përkatësia, etnike, gjuhësore, gjinore, fetare, ekonomike dhe zhvillimore në arsimin fillor dhe të ulët të mesëm.

Përshkrimi:

MASHT-i zhvillon dhe promovon politika gjithëpërfshirëse për përfshirjen e të gjithë grup moshave 6-15 vjeçare duke hartuar ligje, që sigurojnë barazinë e plotë, kushte të barabarta, efikasitet dhe efektivitet të lartë në arsim.

Masa 4.2.4.8. Hartimi i politikave për përfshirje të plotë dhe aftësimin e të gjithë fëmijëve pa kurrfarë dallimi, për vazhdimin e shkollimit të mëtejshëm dhe të aftësimin të tyre për t'u përfshirë në tregun e punës.

Përshkrimi:

MASHT-i zhvillon dhe promovon politika gjithëpërfshirëse duke siguruar barazi të plotë për të gjithë qytetarët para ligjit për t'u përfshirë në arsim të lartë të mesëm, në pajtim me informimin dhe orientimin e shprehur profesional, dispozitat dhe mundësitë e tyre psiko-fizike dhe talentin apo prirjet e manifestuara.

Masa 4.2.4.9. Krijimi i mundësive dhe mekanizmave për barasvlerë të arsimit jo formal dhe informal me arsimin formal.

Përshkrimi:

Rishikimi i Ligjit për arsimimin e të rriturve, hartimi i politikave për kualifikime, zhvillimi i sistemit të standardizimit dhe të akreditimit e licencimit, hartimi i një memorandum mirëkuptimi me OJQ-të dhe Shoqërinë Civile, hartimi i nomenklaturës së profesioneve dhe të katalogut të profesioneve të cilat mund të kryhen nga fëmijët e moshës 15 vjeçe (në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës (KKK) neni 3 paragrafi dh, dhe me Konventën për format më të vështira të Punës së Fëmijëve).

Masa 4.2.4.10. Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm, tërheqës, estetikisht të bukur dhe të shëndoshë për mësimdhënie në arsimin fillor dhe të ulët të mesëm.

Përshkrimi:

Krijimi i standardeve të larta për pamjen estetike të shkollave. Krijimi i standardeve të larta higjienike-sanitare dhe zbatimi rigoroz i tyre;

Të gjitha shkollat të kenë kënde për vizuelizimin e mësimin, rampa dhe pajime të tjera për fëmijë që kanë pengesa në zhvillim;

Të gjitha shkollat të furnizohen me ujë bakteriologjikisht dhe kimikisht të pastër;

Të bëhet inspektimi sanitar, higjienik dhe i pamjes estetike të shkollës;

Të kenë dhe t'i plotësojnë standardet për organizimin e strategjive dhe metodologjive të reja, t'i kenë kuzhinat shkollore, bibliotekën dhe mediatekën dhe qasjen në internet (deri në vitin 2017);

Shkollat që ndërtohen pas vitit 2007, të kenë hapësirë për lojë, argëtim dhe sport;

Të hartohen standarde bashkëkohore të lokalit, të pajimeve dhe të mjeteve mësimore të domosdoshme për zbatimin praktik të dijeve. Me standardet e përcaktuara një paralele të ketë më së shumti 25 nxënës.

Masa 4.2.4.11. Të rishikohet dhe në pajtim me këtë të hartohet rrjeti i ri racional i shkollave të arsimit të mesëm të lartë.

Përshkrimi:

Në vitin 2007, MASHT-i në bashkëpunim me partnerët socialë (Odën Ekonomike, Asociacionin e Bizneseve, SBASHK-un, OJQ-të), të rishikojnë hartën e tashme të shkollave dhe të mesme të larta dhe, për vitin 2008, të propozojë një hartë racionale, efikase dhe efektive;

Të hartohen standardet për hapësirë, lokal, pajime dhe mjete mësimore për secilin tip të shkollave të larta të mesme duke përfshirë edhe objektet dhe mënyrat e zhvillimit të punës praktike dhe të praktikës profesionale;

Deri në vitin 2008, secila shkollë e mesme e lartë të jetë e furnizuar me ujë të pastër.

Masa 4.2.4.12. Rishikimi i strukturës së tashme të shkollave të mesme të larta dhe përshtatja e saj nevojave zhvillimore të Kosovës, luftimit të varfërisë dhe krijimit të mundësive për punësimin e të rinjve.

Përshkrimi:

Në fillim të vitit 2007, të formohet një komision nacional që të rishikohet struktura e tashme e arsimit të mesëm. Të analizohet se a është i nevojshëm gjimnazi i përgjithshëm dhe a duhet të zgjasë katër vjet;

Të rishikohet se për cilët lëmenj profesionalë ka nevojë tregu i punës sot, pa i lënë anash edhe parashikimet e tendencat tjera zhvillimore;

Të krijohet një strukturë e arsimit të mesëm, që mundëson aftësimin për 6 muaj, për një vit dhe për dy vite. Ky aftësim do të jetë i përshtatshëm për ata kandidatë, që kanë nevojë më të madhe për sigurimin e ekzistencës;

Të hartohet nomenklatura e profesioneve të këtitilla. Këto janë shkolla të zanateve. Në shkollat katërvjeçare profesionale në të cilat fitohet licenca e teknikut të shkojnë nxënësit të cilët mendojnë të punësohen, por edhe të vazhdojnë studimet. Duhet rishikuar mundësinë edhe të shkollimit 5 vjeçar profesional (në këtë shkollim përfshihen të gjithë ata, që e kanë licencën e teknikut dhe kanë së paku një vit përvojë pune në profesionin e caktuar).

Pas përfundimit të vitit të pestë e fitojnë licencën e specialistit për profesione të caktuara.

Masa 4.2.4.13. Rishikimi i programeve për përgatitjen e mësimit në arsim.

Përshkrimi:

Rishikimi i programeve të fakulteteve, që përgatisin kuadër për arsim fillor, arsim të ulët të mesëm dhe arsim të lartë të mesëm me programet e fakulteteve përkatëse të UE-së dhe harmonizimi i tyre. Rishikimi të bëhet në vitin 2007, ndërsa harmonizimi i tyre të bëhet deri në vitin 2008.

Të hartohen dhe kreditohen programe, që janë në pajtim me programet e UE-së dhe me procesin e Bolonjës.

Masa 4.2.4.14. Rishikimi i kapaciteteve të kuadrit në fakultetet, që përgatisin kuadër për mësimit në arsim.

Përshkrimi:

Rishikimin e kapaciteteve duhet ta bëjë një këshill nacional me ekspertë ndërkombëtarë dhe mbi bazën e kriterëve të matshme dhe objektivave për të parandaluar çdo mundësi abuzive;

Mësimit në arsim që premtojnë dhe tregojnë interes e aftësi për t'i plotësuar këto kriterë duhet t'u krijohet mundësia për trajnime intensive.

Mundësitë që të marrin kreditë e domosdoshme në fakultet, që përgatisin kuadër për të marrë licencën e mësimit në arsim.

Masa 4.2.4.15. Zhvillimi profesional i mësimit në arsim.

Përshkrimi:

Të krijohen kushte materiale dhe financiare duke shfrytëzuar edhe kapacitetin e shoqërisë civile dhe të OJQ-ve, shoqatave të ndryshme profesionale, të partnerëve të tjerë socialë, në mënyrë që të gjithë mësimit në arsim të përfshihen në zhvillime

profesionale në suaza të lëmenjve që ata i zhvillojnë, por edhe të metodologjive dhe të strategjive të reja të bazuara në njohjet më të reja shkencore të pedagogjisë, psikologjisë, teknologjisë së re informative (TRI) dhe të teknologjisë së re arsimore (TRA).

Mësimdhënësit të cilët tani janë duke punuar si mësimdhënës dhe të cilët nuk i kanë përfunduar studimet në fakultete arsimore duhet të marrin kreditë në Fakultetin e Edukimit, natyrisht, duke marrë parasysh jo vetëm kualifikimin arsimor, por edhe aftësimin profesional personal të individit si dhe referencat nga personat përgjegjës”⁴.

Masa 4.2.4.16. Ndërtimi i sistemit funksional të përparimit në karrierë.

Përshkrimi:

Rishikimi i rregullores për licencimin e mësimdhënësve dhe ndryshimi i saj. Pas përfundimit të Fakultetit të Edukimit, studentët do të duhej të merrnin licencën e mësimdhënësit fillestar. Bashkëngjitur më diplomën ata do të duhej të merrnin edhe Programin e zhvillimit profesional fillestar një vjeçar. Me rastin e punësimit, monitorohet puna e mësimdhënësit fillestar praktikant, nga mësimdhënësit mentorë. Pas një viti përvojë pune dhe rekomandimit të mentorit dhe të portofoljes së tij, mësimdhënësi fillestar merr thirrjen e mësuesit të merituar. Në bazë të programeve të akredituara dhe të standardeve paraprakisht të hartuara, mësuesi i merituar mund të gradohet në mësues të avancuar dhe mësues mentor-këshilltar.

Të sigurohet mbështetja financiare për sigurimin e avancimit në karrierë. Deri në vitin 2015, të gjithë mësimdhënësit do të duhej t’i vënë në praktikë 12 shkathësitë e mësimdhënies dhe të njohin në shkallë të lartë stilet e të nxëniet.

Masa 4.2.4.17. Krijimi i një sistemi të kontrollit sistematik të shëndetit fizik dhe psikik të mësimdhënësve

Përshkrimi:

Numër i konsiderueshëm i mësimdhënësve që punojnë në arsim për shkak të statusit të pazgjithur, pozitës së vështirë materiale, punojnë në arsim me një shëndet të rrënuar, i cili pos që reflektohet në efikasitetin dhe efektivitetin e sistemi të arsimit, ka ndikim të drejtpërdrejtë edhe në shëndetin fizik të nxënësve dhe në zhvillimin e tyre në përgjithësi. Studimet kanë treguar se mësimdhënësi me teke neurotike, për dy muaj i zhvillon teket neurotike tek nxënësit. Të krijohet një fond për pensionimin e parakohshëm të mësuesve, që nuk kanë shëndet fizik dhe psikik për punë me nxënës. Në çdo vit të bëhet kontrolli sistematik i shëndetit të mësimdhënësve.

Masa 4.2.4.18. Të themelohen shërbimet profesionale.

Përshkrimi:

Me qëllim të zhvillimit të plotë të personalitetit të fëmijëve, inkurajimit të fëmijëve, që kanë vështirësi në nxënie, zhvillimit maksimal të fëmijëve që kanë prirje dhe talent të veçantë të krijimit të “extra vlerave” tek secili nxënës, duhet të fuqizohen shërbimet

⁴ MASHT, Këshilli i Ekspertëve për Arsim Parauniversitar(2006): Strategjia për zhvillimin e arsimit parauniversitar në Kosovë 2007- 2017, Prishtinë, f.36

profesionale pedagogjike. Duhet hartuar programin e trajnimit të pedagogëve, psikologëve, të punëtorëve socialë dhe mjekëve për shëndetin oral dhe të pediatërve.

Masa 4.2.4.19. Të rishikohen kurrikulat e tashëm të miratuar.

Përshkrimi:

Të rishikohet korniza kurrikulare dhe të miratohet. Qasja mono-disiplinare të zëvendësohet me qasje integrale. Objektivat e arritjes të jenë kriter për përzgjedhjen e përmbajtjeve programore dhe standardeve të përmbajtjes. Në klasën e IX-të, të futet sistemi modular, i cili do të ndihmojë orientimin dhe informimin profesional. Të hartohen udhëzime të detajuara për lëndët opcionale. Në kurrikula të përcaktohen vetëm lëndët bazike, që janë në interes të shtetit dhe të sundimit të ligjit. Në nivele rajonale të caktohen lëndët, që janë në interes për rajonin, ndërsa në nivelin lokal të përcaktohen lëndët, që janë në interes të komunitetit.

Në arsimin e lartë të mesëm, të parashihen lëndët që lidhen me zhvillimet teknike teknologjike dhe shkencore, mësim i thelluar i gjuhëve të huaja, varësisht nga tipi i shkollës. Në shkolla katërvjeçare profesionale, në vitet e para duhet të jenë dominante lëndët e arsimit të përgjithshëm, ndërsa nga klasat e dyta të jenë lëndët profesionale me 40 % praktikë. Në klasën e tretë, lëndët profesionale dhe lëndët e ngushta profesionale, të jenë të balancuara me 50% punë praktike dhe në klasën e IV-të të jenë lëndët e ngushta profesionale me 60% të kohës, punë praktike dhe praktikë profesionale, duke futur edhe arsimin dual të mesëm profesional.

Të krijohen kushte optimale për zhvillimin e mësimin praktik dhe të praktikës profesionale. Të gjithë kurrikulat të përshkohen me frymën dhe filozofinë e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës.

Masa 4.2.4.20. Të krijohet një sistem funksional i monitorimit dhe i vlerësimit të zbatimit të kurrikulave.

Përshkrimi:

Megjithëse Kosova ngec në teknologjinë e re dhe mundësitë e reja, (për këtë qëllim po hartohet kjo strategji dhe strategjitë e tjera të cilat së bashku synojnë të zënë hapin e zhvillimit dhe zvogëlojnë diskrepancën në zhvillimin e Kosovës me vendet tjera) prapë se prapë Kosova po hyn – futet në “*Shoqërinë e Dijes*” (ky integrim është edhe vizion i Strategjisë për arsimin parauniversitar”, të paktën të informacionit”, ashtu siç thotë profecia e gjenit Winston Chërçill, “Perandoritë e së ardhmes do të jenë perandoritë e mendjes” dhe kjo, gjithnjë e më shumë po bëhet realitet. Kurrikulave të përqendruar në lëndë u ka kaluar koha. Tani kurrikulat më shumë duhet të kthehen drejt njeriut dhe natyrës së tij. Por për të bërë ndryshime kurrikulare, duhet tjetër strukturë të Njësisë kurrikulare dhe tjetër koncept i kësaj njësie. Për këtë qëllim duhet të bëhen trajnimet e punëtorëve të kësaj njësie apo reformim radikal të saj në mënyrë që ajo të aftësohet për të zbatuar filozofinë postmoderne të teorisë kurrikulare.

Për këtë qëllim nevojitet të hartohet një metodologji e sofistikuar për përcjelljen e vlerësimit si dhe për të bërë ndryshime kurrikulare.

Masa 4.2.4.21. Të hartohen standardet e avancuara për përgatitjen, hartimin, vlerësimin e teksteve dhe për monitorimin e zbatimit të tyre.

Përshkrimi:

Të rishikohet ligji ekzistues për botimin e librave shkollorë, mjeteve mësimore dhe të lekturës shkollore me qëllim që të evitohen praktikat korruptuese, monopoli i grupeve të caktuara të interesit. Të formohet këshilli i ekspertëve sipas fushave me qëllim që të sigurohet cilësia e teksteve. Të liberalizohet tregu duke nxitur konkurrencë të mirëfilltë. Për shkolla të mesme dhe bashkësitë minoritare të garantohet barazia duke siguruar të gjitha tekstet cilësore edhe për nxënësit e këtyre bashkësive etnike dhe duke krijuar mundësi të përdorimit të teksteve nga shtetet amë, që natyrisht i plotësojnë kriteret profesionale, pedagogjike, ilustruese dhe teknike.

Masa 4.2.4.22. Të hartohen standardet që sigurojnë pritshmëri të larta në efikasitet dhe në efektivitet në arsimin fillor dhe të ulët të mesëm.

Përshkrimi:

Deri në vitin 2009, të gjithë mësimdhënësit e Kosovës të arsimit fillor të aftësohen për zbatimin e metodologjive të reja të mësimdhënies: Zhvillimi i Mendimit Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit, Mësimdhënien ndërmjetësuese, Mësimdhënien e programuar, problemore etj. Të gjithë drejtorët e shkollave të aftësohen më një program të avancuar për shndërrimin e shkollave në organizata të fuqishme të prodhimit të dijeve të vlefshme dhe të qëndrueshme. Të gjitha shkollat e Kosovës t'i kenë 11 karakteristikat e shkollave efektive. Këshilltarët për të drejtat e fëmijës do të kenë detyra e angazhime nga dy orë në javë, që do të llogariten në kontratë të punës 42 orëshe dhe ata në mënyre sistematike, do të punojnë me Komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Të hartohen dhe publikohen standardet për avancim maksimal efikas dhe efektiv deri në vitin 2008, që do të duhej të jenë në pajtim me cilësitë dhe standardet e UE-së. Të ndërpritet braktisja e arsimit. Deri në vitin 2015, të gjithë nxënësit në mësimdhënie dhe në nxënie të jenë në gjendje të përdorin dhe t'i zhvillojnë 12 shprehitë e të menduarit. Të gjithë nxënësit e Kosovës të jenë të aftë të mësojnë gjatë gjithë jetës dhe të kalojnë "hendekun digjital".

Masa 4.2.4.23.:

Të krijohet një sistem i masave për pjesëmarrje të nxënësve të Kosovës në garat e ndryshme ndërkombëtare në PISA, në matematikë dhe në shkencat e natyrës.

Përshkrimi:

Të krijohet një pako masash dhe veprimesh me të cilat do të arrihet një rritje e përsheptuar e efikasitetit dhe efektivitetit në arsimin e detyruar. Në vitin 2007, të formohet një grup ekspertësh për përgatitjen e "Maturës së Vogël" të cilës nxënësit do t'i nënshtrohen pas përfundimit të klasës së IX-të, sepse testi kombëtar i mbajtur deri më tani nuk ka dëshmuar për shndërrimin e dijeve në kompetenca.

Matura do të përfshinte vlerësimin e dijeve dhe të shkathtësive për lexim dhe shkrim në tri gjuhë mësimore, matematikë dhe shkencat e natyrës.

Grupi ka për detyrë të përhapë informacione për programet ndërkombëtare, në të cilat garojnë shtetet dhe vendet e UE-së. Po ashtu ky grup ka për detyrë të përgatisë teste

nacionale për verifikimin e avancimeve në gjuhë dhe në matematikë pas përfundimit të arsimit fillor.

Në përfundim të klasës së IX-të, nxënësit duhet të jenë në gjendje:

të shkruajnë pa gabime në gjuhën shqipe, angleze dhe në një nga gjuhët tjera botërore apo të rajonit;

Në vitin 2015, në arsimin e detyruar nxënësit e Kosovës do të jenë në mesin e 15 vendeve të para në gjuhë dhe matematikë në programin PISA.

Masa 4.2.4.24. Të krijohet një sistem i masave ligjore, psikologjike për përparime akcelervative dhe financiare të fëmijëve, që tregojnë arritje të larta në nxënie në lëndë dhe lëmenj të caktuar.

Përshkrimi: Në sistemin e deritashëm të arsimit nxënësit që kanë treguar dhe pasur prirje e talent të veçantë për shkak të qasjes tradicionale, nuk e kanë gëzuar të drejtën në arsim efikas dhe efektiv, i cili nuk i ka kontribuar zhvillimit të tyre, por përkundrazi ka pasur ndikime dhe implikime negative, sepse janë deprimuar, kanë nxitur reagime dhe revolta nga të cilat janë replikuar sjelljet asociale, që jo rrallë kanë përfunduar me delikuencë, përdorim të materieve toksike, të drogës, (vetëm brenda këtij viti dy të rinj kanë vdekur nga “over doza”) duhanit, alkoolit etj.

Masa 4.2.4.25. Hartimi i masave për rritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të mësimdhënies dhe të nxënies në arsimin e lartë të mesëm

Përshkrimi:

Të hartohen standarde dhe kritere të larta të arritjeve sipas tipave të shkollave të mesme të larta. Këto standarde duhet të hartohen gjatë vitit 2007. Për këtë qëllim formohet një Këshill nacional për avancimin e efikasitetit dhe të efektivitetit të mësimdhënies dhe të nxënies në arsimin e mesëm të lartë.

Në shkollat e zanateve të avancohet sistemi i provimit përfundimtar në të cilin nxënësit do të kenë mundësi të tregojnë shkathtësitë praktike dhe njohjet teorike për profesionin e ardhshëm.

Ndërsa në shkollat katërvjeçare të mesme të përgjithshme dhe profesionale të avancohet sistemimi i maturimit, përkatësisht të provimit të maturës, në të cilin nxënësve do t’u jepet mundësia që të tregojnë aftësinë për të nxënë gjatë gjithë jetës, njohjen teorike të profesionit apo të fushës të cilën e kanë përzgjedhur, njohjen e gjuhëve të huaja, gjuhës amtare dhe të matematikës dhe në një lëndë profesionale (në shkollat e mesme profesionale katërvjeçare).

Në shkollat e mesme pesëvjeçare profesionale, në provimin e specializimit, nxënësit duhet të tregojnë shkathtësi të veçanta të avancimit, udhëheqjes, planifikimit, komunikimit dhe të zbatimit të teknologjisë së re informative në fushën e specializuar.

Masa 4.2.4.26. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit duke krijuar partneritet dhe binjakëzim me shkollat brenda vendit, në rajon dhe në Evropë.

Përshkrimi:

Në proceset e globalizimit dhe kohës postmoderne, nevojitet partneritet në parimin e profesionalitetit dhe të kërkesës për të nxënë gjatë gjithë jetës dhe të krijohen rrjete,

konsorciume të të nxënit, “afrimi i të mësuarit pranë shtëpisë”. Për këtë qëllim MASHT-i do të duhet të përkrahë institucionet arsimore, të cilat do të krijojnë rrjete të tilla për ura miqësie ndërmjet popujve dhe vendeve të ndryshme (qarkullimi i njerëzve, kapitalit të dijes, njohja e diplomave ekuivalente) dhe krijimi i qendrave mësimore për mësim të përditshme në të cilat mbledhen më shumë njerëz, jo vetëm në shkollë, por edhe në salla, biblioteka, në shtëpi të kulturës, në muze, objektet e kulturës, parqe, sheshe publike, qendra shëndetësore, kënde të çlodhjes dhe të argëtimit, mensat e ndërmarrjeve etj⁵.

Masa 4.2.4.27. Krijimi i një sistemi të masave për eliminimin e braktisjes dhe luftimit të delikuencës së të miturve.

Përshkrimi:

Delikuenca nga të miturit është një problem që është duke e shqetësuar shoqërinë kosovare. Duhet ndërmarrë masa dhe veprime konsistente dhe të sinkronizuara për mënjanimin e fenomenit të braktisjes së shkollimit dhe të luftimit energjik të dukurisë së delikuencës nga të miturit. Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit në sistemin e arsimit është masa më efikase për krijimin e një bashkëpunimi më të fuqishëm dhe më funksional ndërmjet shkollës dhe familjes (duhet gjetur metoda dhe mënyra për ta bërë këtë). Pastaj bashkëpunimi më i madh dhe më funksional i shkollës me ShPK-në, Qendrën Sociale, fuqizimi i shërbimeve pedagogjike dhe psikologjike në shkollë. Për t’i realizuar të gjitha këto, në vitin 2007, të formohet një këshill i përbashkët për parandalimin e fenomenit të braktisjes së shkollimit dhe të eliminimit të delikuencës nga të miturit. Ky këshill do të përbëhet nga përfaqësues të MASHT-it, MPMS-së, MSh-së, MD-së, MBPA-së, përfaqësues të prindërve dhe të OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të fëmijës. Ky këshill deri në fund të vitit 2007, duhet të dalë më një plan veprimi për parandalimin e këtij fenomeni, integrimin e fëmijëve, që deri më tani kanë rënë në konflikt me ligjin dhe kanë treguar të meta edukative, sjellje asociale dhe veprime të kundërligjshme.

Masa 4.2.4.28. Krijimi i një sistemi për mbrojtjen dhe parandalimin e përdorimit të duhanit, alkoolit, të materieve toksike dhe të drogave.

Përshkrimi:

Siç tregon studimi për gjendjen e të drejtave të fëmijës numër i madh i nxënësve të rinj e konsumojnë duhanin, alkoolin dhe janë përdorues të drogave. Për këtë qëllim duhet ndërmarr këto veprime: Në kurrikula dhe tekste shkollore të këtë më shumë përmbajtje për dëmet që shkaktojnë përdorimi i këtyre materieve për shëndetin e njeriut, pasojat që kanë familjet dhe shoqëria nga konsumimi i këtyre materieve. Po ashtu duhet formuar një komitet të përzier që do të organizonte fushata për parandalimin, rehabilitimin dhe integrimin e këtyre të rinjve në shoqërinë kosovare. Të shikohet mundësia që mësimdhënësit dhe mjekët të mos e konsumojnë duhanin dhe alkoolin, sepse të rinjtë mësojnë shumë nga modelet e sjelljeve të mësimdhënësve dhe të mjekëve. Me ligj rreptësisht të ndalohej pirja e duhanit dhe alkoolit e mbajtja e tyre në institucionet arsimore. OJQ-të për të drejtat e fëmijës dhe të njeriut në

⁵ Shih më gjerësisht: Dokumente themelore ndërkombëtare për arsimin dhe të të mësuarit. Ndërmarrja e veprimeve në fushën e të mësuarit gjatë gjithë jetës: gjashtë mesazhe kryesore (IBNSHGJ) ,f.75-92

bashkëpunim me organet kompetente për çdo vjet në vazhdimësi do të organizojnë fushata kundër përdorimit të materieve toksike.

Masa 4.2.4.29. Sigurimi i një sistemi për përzgjedhjen e udhëheqësve të aftë për qeverisje dhe udhëheqje në arsim, në të gjitha nivelet e arsimit.

Përshkrimi:

Në të gjitha studimet meta-analitike është vërtetuar se nuk ka dhe nuk ekziston lidhje korrelative pozitive ndërmjet një shkolle të suksesshme dhe të lidhshme të dobët. Me fjalë të tjera hulumtimet shkencore pa përjashtim kanë konstatuar se nuk mund të ketë shkollë efikase dhe efektive me drejtore të dobët dhe inkompetent. Por kjo nuk vlen vetëm për nivelin shkollor, kjo vlen edhe për nivele tjera më të larta. Nga një konstatim i këtillë mund të nxjerrim përfundimin i cili përçon mesazhe shumë të qarta. Secila përzgjedhje joadekuade e udhëheqjes së institucioneve është faktor vendimtar për shkeljen e të drejtave të fëmijës. Të gjitha zgjedhjet e këtilla të motivuara nga përkatësia politike, nepotiste, klanore, atakojnë drejtpërdrejtë të drejtat e fëmijës. Duhet krijuar standarde dhe kritere rigorozë për përzgjedhjen e drejtorëve, në një anë dhe, në anën tjetër, zëvendësimin e të gjithë atyre drejtorëve në të cilat shkollat nuk janë efikase dhe efektive. Kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve duhet të definohen shumë qartë gjatë vitit 2007. Me këto kritere, duhet të objektivizohet mundësia e përzgjedhjes, sepse të drejtat e fëmijës janë gjëja më e çmuar për një komb, që mëton zhvillim të hovshëm, kohezion social dhe qytetarë të lumtur.

Masa 4.2.4.30. Ndërmarrja e masave për përmirësimin e pozitës dhe të statusit social dhe material të punëtorëve të arsimit.

Përshkrimi:

Arsimi është një ndër komponentët kryesorë të zhvillimit njerëzor dhe të kapitalit social. Përmes arsimit zhvillohen aftësitë dhe dispozitat, që lidhen me aktivitetet ekonomike. Për këtë arsye, në të gjitha hulumtimet e bëra është konstatuar se arsimi është kategoria më propulzive ekonomike. Për këtë shkak në ShBA: "*Shkollat konsiderohen industria më e madhe e Amerikës*". Po kështu nga kjo fuqi botërore thuhet se: "Vetëm arsimi ëndërrat amerikane i bën realitet". Irlanda dhe Finlanda, Tajvani, Koreja Jugore dhe së fundi edhe India me reforma arsimore kanë arritur një zhvillim të hovshëm ekonomik dhe mirëqenie sociale. Në Irlandë thuhet nëse dëshiron zhvillim ekonomik, duhet arsim cilësor, por nëse dëshiron arsim cilësor duhen mësues të paguar mirë. Meqë zhvillimi njerëzor dhe formimi i kapitalit social fillon nga moshë parashkollore duhet përmirësuar statusin social dhe material të punëtorëve të arsimit. Statusi jo i favorshëm i punëtorëve të arsimit është një ndër shkaktarët kryesorë të shkeljes së të drejtave të fëmijës në Kosovë. Në vitin 2007 duhet krijuar një grup ekspertësh për të kërkuar zgjidhje për përmirësimin e statusit social dhe material të punëtorëve të arsimit. Thëniet e politikanëve për pamundësinë e përmirësimit të statusit social dhe material të punëtorëve të arsimit, është një deklaratë, thënë më eufemizëm, një mosnjohje apo mungesë e vullnetit, sepse ka shumë alternativa për zgjidhjen e këtij problemi, pa zgjidhjen e të cilit nuk ka avancim të të drejtave të fëmijës, nuk ka shtet ligjor, nuk ka punësim, nuk ka luftë të suksesshme të varfërisë e as zhvillim ekonomik.

SUPOZIMET KRITIKE

Teoria e ndryshimeve në arsim na mëson se në kohën e ndryshimeve marramendëse, diversitetit të madh, interesave të ndryshme, që ndryshe kategorizohen si kohë e kaosit të të nxëniet dhe ndryshimit ndodhin në cepin e kaosit, të një balancimi ndërmjet rregullave të tepërta dhe mungesës së rregullave, reales dhe të ideale, mundësive të limituara dhe aspiratave maksimale.

1. Ekziston rreziku që mos të sigurohet një balancë politike, që të mos ketë gatishmëri të mjaftuar dhe vendosmëri politike për të përkrahur ndryshimet edhe për shkak të përcmimit të rolit që ka edukimi i fëmijëve dhe të mosnjohjes së rëndësisë së të drejtave të njeriut dhe të arsimit. Po ashtu ekziston mundësia që të mungojë gatishmëria e njerëzve të cilët merren me politika zhvillimore. Kapaciteti i pamjaftueshëm i institucioneve arsimore për përfshirje në ndryshime të thella. Varfëria, shkalla e ulët e vetëdijesimit të opinionit dhe mendësia e vjetër si dhe mospërfshirja e komunitetit në ndryshime. Mungesa e interesimit të mediave si fuqia e katërt, mund të paraqet një rrezik që mund të pengojë zbatimin e Strategjisë. Motivimi i ulët dhe statusi i pazgjdhur i punëtorëve të arsimit mund të paraqesë rrezik për jetësimin e kësaj strategjie.

Mosinvestimi në zhvillime rurale mund të stimulojë migrimin në qytetet, që më pas mund të paraqesë rrezik për zbatimin e strategjisë. Mbajtja e monopolit në nivele qendrore, seleksionimi negativ i kuadrit, mospajtimi i burimeve alternative etj., paraqesin një supozim kritik.

OBJEKTIVA 5

Masa 4.2.5. Sistemi i avancuar i arsimit special për fëmijët me pengesa të lehta në zhvillim dhe i përkujdesjes së plotë sociale dhe shëndetësore për fëmijët me pengesa të rënda në zhvillim.

Fëmijët me pengesa në zhvillim bëjnë pjesë në kategorinë e fëmijëve me vështirësi më të mëdha në realizimin e të drejtave të parapara me KDF.

Në nenin 23 të KDF-së, në pikën 1, thuhet: “ Shtetet palë pranojnë që fëmija me paaftësi mendore ose fizike duhet të bëjë jetë normale dhe të përshtatshme në kushtet, që garantojnë dinjitetin e tij, që nxisin autonominë dhe lehtësojnë pjesëmarrjen aktive të fëmijës në jetën e bashkësisë”. Më pas thuhet se: “Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës me paaftësi për kujdes të posaçëm dhe nxisin e sigurojnë brenda mundësive të të ardhurave të disponueshme dhënien e fëmijës, i cili i përmbush kushtet, si dhe të atyre që kujdesen për të, të ndihmës që kërkohet dhe që i përshtatet gjendjes së fëmijëve dhe të gjendjes financiare të prindërve të tij ose atyre që kujdesen për të”. Në vazhdim të këtij neni thuhet se ndihma e dhënë jepet falas sa herë që është e mundur duke synuar që fëmijët me paaftësi të kenë mundësi efektivisht të marrin dije, kualifikim, shërbime shëndetësore, shërbime riaftësimi, përgatitje për punësim dhe veprimtari argëtuese në mënyrë që fëmija të sigurojë një integrim shoqëror dhe zhvillim vetjak ose më të plotë duke përfshirë edhe zhvillimin kulturor dhe shpirtëror.

Në studimin e gjendjes së këtyre fëmijëve dhe të rriturve të kësaj kategorie kemi konstatuar se me gjithë përmirësimet, nga viti 1999, falë angazhimeve të shumë organizatave ndërkombëtare dhe vendore, FSDEK-ut; si fëmijët ashtu edhe të rriturit me paaftësi dhe me pengesa në zhvillim janë të diskriminuar dhe nuk janë të barabartë me të tjerët dhe nuk i realizojnë të drejtat e parapara me instrumente dhe standarde

ndërkombëtare. P.sh. shumë të rritur edhe pse të kualifikuar, por me pengesa në zhvillim nuk punësohen dhe nuk priten mirë nga institucionet publike. Vetëm 7 % e fëmijëve me pengesa në zhvillim janë të përfshirë në sistemin e edukimit formal dhe publik. Përkujdesja e shoqërisë për këtë kategori është minimale, andaj në këtë fushë deri në vitin 2017 duhet bërë përmirësime të mëdha, nëse mendojmë të jemi një shoqëri demokratike, humane dhe vend ku sundon ligji.

MASAT

Masa 4.2.5.1. Krijimi i një sistemi të masave për identifikimin e të gjithë fëmijëve me nevoja të veçanta dhe kategorizimi i tyre sipas llojeve të dëmtimit dhe shkallës së dëmtimit.

Përshkrimi:

Në Kosovë një kohë të gjatë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë. Për shkak të paragjytimeve të prindërve, kjo kategori e fëmijëve nuk paraqitet nga prindërit nga frika e stigmatizimit. Gjenda e rëndë ekonomike dhe varfëria ka bërë që kujdesi shoqëror për këta fëmijë të mos jetë në nivelin e duhur, andaj nga viti 2007 deri në vitin 2009, duhet krijuar një strategji për identifikimin e këtyre fëmijëve.

Masa 4.2.5.2. Të krijohen mundësi për ndërtimin e objekteve shëndetësore dhe rehabilituese për ofrimin e përkujdesjes së duhur profesionale, pedagogjike dhe sociale të fëmijëve me dëmtime të rënda.

Përshkrimi:

Me një koordinim të programuar të shoqërisë civile me organet shtetërore dhe në bashkëpunim edhe me institucionet ndërkombëtare, të ndërtohen kapacitete dhe hapësira për sigurimin dhe trajtimin e duhur social, arsimor, shëndetësor dhe rehabilitues të fëmijëve me dëmtime të rënda.

Masa 4.2.5.3. Deri në vitin 2017, të dyfishohet numri i shkollave speciale dhe të krijohen kushte për t'i përfshirë qind për qind fëmijët me pengesa të lehta në zhvillim, në arsimimin parauniversitar duke filluar nga edukimi parashkollor.

Përshkrimi:

Pas identifikimit me akte ligjore të krijohen kushte për përfshirje të plotë të fëmijëve me dëmtime të lehta dhe të rënda në arsimim, të sigurohen tekste, libra, të hartohen bërthama kurrikulare për shkathtësitë, që janë të përshtatshme për ta, të bëhet trajnimi intensiv i personelit mësimor edukativ.

Në çdo vit personat e caktuar nga kjo fushë të raportojnë për gjendjen e të drejtave të fëmijëve me nevoja të veçanta.

Me ligj, institucionet publike dhe jo publike, të obligohen për pranim në punë të personave me paaftësi. Qeveria, të ndajë një fond të veçantë për ndihmë familjeve, që kanë fëmijë me nevoja të veçanta.

SUPOZIMET KRITIKE

Mungesa e ndërgjegjes, paragjykimet dhe mungesa e vullnetit politik mund të jenë faktorë, që të mos realizohet ky objektivi.

OBJEKTIVA 6

Masa 4.6. Sistemi i ndërtuar për zhvillimin e fëmijëve nëpërmjet pushimit, kohës së lirë, lojës, aktiviteteve çlodhëse.

Koha e lirë, aktivitetet çlodhëse dhe pushimet janë të drejtat që fëmijëve u garantohen me KDF. Në nenin 31, në pikën 1 thuhet: Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijëve për pushim dhe kohë të lirë për pjesëmarrje në lojëra dhe në veprimtari çlodhëse në përshtatje me moshën e fëmijës si dhe pjesëmarrjen lirisht në jetën kulturore dhe artistike. Në pikën 2 thuhet se “shtetet palë inkurajojnë sigurimin e mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kohën e lirë dhe për veprimtari kulturore, argëtuese dhe çlodhëse.

Lojërat, koha e lirë dhe aktivitetet kulturore e artistike ndihmojnë zhvillimin e hovshëm mendor shpirtëror, social dhe e begatojnë jetën emocionale të fëmijëve. Kosova me gjithë përparimet e bëra të vogla në vitet e fundit, pak ka bërë që kjo e drejtë e fëmijëve të realizohet. Në lojërat e përbashkëta, fëmijët edukohen për miqësi, tolerancë, i shohin dhe i manifestojnë dispozitat e veta, krijojnë perceptim real për veten.

Masa 4.2.6.1 Deri në vitin 2017 në secilin lokalitet, qytet, lagje të formohen qendra rekreative për aktivitetet çlodhëse dhe artistike.

Përshkrimi:

MAShT-i, Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, Ministria e Ambientit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Shoqëria Civile, OJQ-të, Kuvendet komunale, Bashkësitë lokale dhe komunitetet, të hartojnë një plan veprimi në secilën lagje dhe në secilin fshat ku fëmijët do të jenë në gjendje të merren me aktivitete kulturore dhe artistike. Në nivel qendror mund të hartohet një projekt **unik**, që më pastaj do të mund të përshtatej për secilin vend.

SUPOZIMET KRITIKE

Kufizimet ekonomike dhe vullneti politik

OBJEKTIVA 7

4.7 Sistemi i krijuar efikas për parandalimin e dhunës, të të gjitha formave të eksploatimit dhe trafikimit të qenieve njerëzore.

Me nenet 19 të KDF-së, është i ndaluar përdorimi i çfarëdo forme të dhunës fizike ose mendore, fyerjes ose keqtrajtimit, braktisjes apo të mospërfilljes, nëpërkëmbjes ose të shfrytëzimit duke e përfshirë edhe abuzimin seksual. Me nenin 32 të KDF-së përcaktohet shumë qartë dhe thuhet se: “Shtetet palë njohin të drejtën e fëmijës për t’u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose cenon edukimin e tij, dëmton shëndetin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Me këtë nen, përcaktohet obligimi i Shteteve, të cilat ndërmarrin të gjitha masat legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative nga format e përmendura të dhunës dhe të eksploatimit. Po ashtu, me këtë nen, në paragrafët (a), (b), (c), shtetet, obligohen të sigurojnë: një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit

në punë; një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës dhe, dënime ose sanksione të tjera për zbatimin efektiv të këtij neni.

Me nenin 33 të KDF-së, Shtetet palë obligohen të marrin të gjitha masat për të mbrojtur fëmijët nga shfrytëzimi i paligjshëm i drogave narkotike dhe i lëndëve psikotrope për të parandaluar shfrytëzimin e fëmijëve për prodhimin dhe trafikimin e paligjshëm të këtyre lëndëve.

Me nenin 34 shtetet obligohen të ndërmarrin të gjitha masat për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e shfrytëzimit dhe të keqtrajtimit seksual si dhe për të parandaluar që: fëmijët të nxiten ose të detyrohen të përfshihen në veprimtari të paligjshme seksuale; fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme; fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike.

Me nenin 35 të KDF-së Shtetet palë të marrin të gjitha masat për parandalimin e trafikimit të fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme tjetër.

Në të gjitha hulumtimet e pavarura, raportimet e organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare ka të dhëna të shumta për dhunën e ushtruar nga të gjitha format në familje, në shkolla, për shfrytëzimin dhe abuzimin seksual, për punën e rëndë të fëmijëve që është në kundërshtim me KDF-në. Për këto shkelje të të drejtave të fëmijës flitet mjaft qartë në raportin e studimit.

Me strategji duhet krijuar mundësi që deri në vitin 2017, asnjë fëmijë të mos jetë i keqtrajtuar, objekt dhune, të mos shfrytëzohet dhe abuzohet seksualisht, të mos kryejë punë që shkaktojnë dëmtime të rënda fizike dhe psikike.

TREGUESIT

Në vitin 2017:

Nuk duhet të ketë raste të përdorimit të dhunës në institucionet shkollore

Shkalla e përdorimit të dhunës në familje nuk duhet të kalojë 1%/ hulumtimet e shpejta/

Nuk duhet të ketë raste të shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime ekonomike

Nuk duhet të ketë raste të abuzimit seksual me fëmijë

Nuk duhet të ketë raste të trafikimit të fëmijëve

MASAT

Masa 4.2.7.1. Viti 2007 të shpallet viti i luftimit të të gjitha formave të përdorimit të dhunës dhe të keqtrajtimit të fëmijëve në familje, shkollë dhe rrugë.

Përshkrimi: Organizatat joqeveritare, organet e shtetit, mediave të shkruara dhe elektronike nën patronatin e Qeverisë së Kosovës të organizojnë një fushatë një njëvjeçare për vetëdijësimin e opinionit për pasojat, që mund të kenë fëmijët dhe shoqëria nga përdorimi i dhunës. Të mbahen ligjërata, të organizohen debate dhe tryeza, të organizohen hulumtime të shpejta për përdorimin e dhunës në familje dhe në institucione. Në shkolla të intensifikohet edukimi i nxënësve për zgjidhje paqësore të problemeve. Këshilltarët për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës të hulumtojnë temperaturën e të drejtave të fëmijës në shkolla, duke u fokusuar në nenet 19, 32, 34, 35, 36, 37 dhe 38 të KDF-së.

Masa 4.2.7.2 Rishikohet korniza ligjore vendore me të cilat masa është sanksionuar dhuna duke vlerësuar edhe zbatimin e saj.

Të rishikohet kjo kornizë ligjore: ligji mbi arsimin fillor dhe të mesëm 2002/2; Ligji mbi barazinë gjinore në Kosovë 2004/2; Ligji mbi martesën dhe raportet familjare (1984); Ligji kundër diskriminimit 2004/3; Rregullorja mbi ndalimin e trafikimit të personave në Kosovë, UNMIK/REG/ 2001/4; Rregullorja mbi mbrojtjen e fëmijëve kundër kidnapimeve UNMIK/REG/2004/29; Rregullorja mbi mbrojtjen nga dhuna familjare, UNMIK/REG/2003/12; Rregullorja mbi mbrojtjen kundër nxitjes së urrejtjes, mospajtimit apo jo tolerancës kombëtare, raciale, fetare apo etnike, UNMIK/REG/2004;Kodin penal; Kodin për procedurën penale; Kodin penal të të miturve. Rivlerësimi duhet të bëhet gjatë vitit 2007.

Të analizohet zbatimi i dispozitave ligjore, të analizohen raportet e organeve përgjegjëse për hetimin e të gjitha formave të dhunës nga: policia dhe divizionet e saj përgjegjëse. Pastaj sektori për Hetimin e Dhunës në Familje që punon në Njësinë për Avokim dhe Ndihmë Viktimave, që është pjesë e Ministrisë së Drejtësisë

Të rishikohen dhe të vlerësohen efektet e zbatimit të dokumenteve dhe udhëzimeve të ndryshme për mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e ndryshme të dhunës

Të vendosen kontakte të përhershme ndërmjet subjekteve të ndryshme që trajtojnë dhe hetojnë dhunën ndaj fëmijëve duke formuar një komitet për mbrojtjen e fëmijëve.

Të rishikohet mundësia për ashpërsimin e sanksioneve në rastet e përdorimit të dhunës(p.sh Lëndim i lehtë trupor, neni 153 gjobë apo burgim deri në tri vjet të bëhet vetëm burg deri në 5 vjet)

Masa 4.2.7.3. Të rishikohet korniza ligjore që ka të bëjë me mbrojtjen e fëmijëve nga puna që dëmton shëndetin fizik dhe psikik të fëmijëve të Kosovës.

Përshkrimi

Kosova ka një legjislaturë të mangët për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Janë dy dokumente ligjore në të cilat mëtohet të bëhet mbrojtja e fëmijëve nga shfrytëzimi ekonomik. Në Kornizën Kushtetuese të Kosovës në nenin 3 të paragrafit dh, është inkorporuar KDF-ja, e cila është e zbatueshme edhe në Kosovë. Përveç kësaj në rregulloren e UNMIK-ut 20001/27 dhe me Ligjin e Punës, të nenit 3, përcaktohet moshë minimale për punë, e kjo është moshë 18 vjeçare.

Megjithatë në paragrafin 2 të kësaj rregulloreje thuhet se:

“ Personi nën moshën 18 vjeçare mund të punësohet për punë më të lehta të cilat nuk e dëmtojnë shëndetin ose zhvillimin e tij apo të saj dhe nuk i pengon për ndjekjen e mësimin në shkollë”. Në paragrafin 3 të nenit 3 thuhet se :”personat nën moshën 15 vjeçare nuk mund të punësohen”.

Fëmijët që punojnë bie në kundërshtim edhe me nenin 31 të KDF-së, si dhe Konventën për format më të rënda të punës të vitit 1999, në të cilin përcaktohen format më të “egra të punës së fëmijëve si: skllavëria, shitja dhe trafikimi, lidhja apo detyrimi më forcë në konfliktet e armatosura, përdorimi i fëmijëve për kryerjen e aktiviteteve të jashtëligjshme, siç janë prodhimi dhe trafikimi i drogave, punët që janë të rrezikshme për shëndetin fizik dhe psikik të fëmijëve, për sigurinë dhe moralin e tyre.

Masa 4.2.7.4. Miratimi i ligjit për parandalimin e kryerjes së punëve të egra nga fëmijët.

Përshkrimi

Pa miratimin e një ligji të këtillë, në Kosovë, nuk mund të parandalohet kryerja e punëve të tilla nga fëmijët. Ky ligj duhet të miratohet deri në fund të vitit 2007.

Masa: 4.2.7.5. Krijimi i një sistemi funksional për identifikimin, trajtimin, integrimin e fëmijëve në sistemin e edukimit dhe të arsimimit.

Përshkrimi:

Në Kosovë nuk ka të dhëna të sakta as për fëmijët që kryejnë punë të rënda, as për llojet e punëve që ata i kryejnë, prandaj duhet siguruar një sistem identifikimi, evidentimi dhe monitorimi. Në të gjitha shkollat e Kosovës duhet të mbahet një dosje e veçantë për fëmijët e varfër, që janë të detyruar të kryejnë punë të këtilla. Nga komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës duhet të hartohet lista e nxënësve të këtillë. Shërbimet pedagogjike, psikologjike dhe sociale në bashkëpunim me komitetet shkollore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës dhe me Qendrat Komunale Sociale, ILO dhe IPEC-un duhet të monitorojnë punën e fëmijëve, të ndihmojnë rehabilitimin dhe integrimin e tyre. Evidentimi dhe identifikimi i tyre të bëhet për çdo vit.

Masa 4.2.7.6. Krijimi i një sistemi të masave për parandalimin e abuzimit dhe të shfrytëzimit seksual të fëmijëve.

Përshkrimi

Në studimin e gjendjes së të drejtave të fëmijës të bërë përmes hulumtimeve vetjake të KEC-it, të studimeve meta-analitike të shtypit të shkruar për dy vite, të studimit të raporteve të organizatave të ndryshme qeveritare dhe joqeveritare, kemi konstatuar keqtrajtimin seksual të fëmijëve si në familje, ashtu edhe në institucionet arsimore dhe në procesin e trafikimit të qenieve njerëzore.

Për këtë arsye duhet ndërmarrë një sërë masash për vetëdijesimin, ashpërsimin e ligjeve për rastet e abuzimeve seksuale, të incestit, etj. Edukimit seksual në institucionet arsimore duhet kushtuar kujdes më të madh. Ndoshta, lënda “Edukata seksuale” duhet të futet si lëndë kroskurrikulare apo si lëndë zgjedhore që nga klasa e VII-të e shkollës fillore.

Në kodin penal duhet ashpërsuar dënimet e krimit, që lidhen me dhunën, shfrytëzimin, trafikun dhe prostitucionin.

Me qëllim të parandalimit të prostitucionit, ndoshta duhet legalizuar këtë dukuri (mendohet për moshën madhore, sepse kjo do të ndikonte që të ndalet shkalla e atakimit të fëmijët).

Po ashtu duhet forcuar këshillimoret dhe qendrat për shëndetin mental për shkak të trajtimit të sëmundjeve të ndryshme, që lidhen me dhunën seksuale (pedofilinë, incestin, ciber-krimin etj.)

Masa 4.2.7.7. Krijimi i një sistemi koherent të masave për parandalimin, zbulimin dhe trajtimin e fëmijëve viktime të trafikimit.

Përshkrimi

Kosova në vend se të bëjë përparim në luftimin e fenomenit të trafikimit, gjithnjë e më shumë po bëhet një ndër vendet me shkallën më të lartë të trafikimit. Kurba –

lakorja në grafik e trafikimit shënon rritje. Po ashtu edhe numri i fëmijëve të trafikuar po rritet. Natyrisht në fillim, Kosova, ishte vend i importit dhe i transitit, tashmë është vend edhe i destinimit. Në fillim, fëmijët vendorë, në përqindje merrnin pjesë me një shkallë të ulët, por tani kjo përqindje sipas studimeve është në rritje e sipër.

Ekziston një rrjet ndërkombëtar, që nuk mund të luftohet vetëm me mjete të brendshme, andaj gjatë vitit 2007 duhet të krijohet një “Ministrategji” për luftimin dhe parandalimin e plotë të këtij fenomeni. Në shkolla ku funksionojnë komitetet shkollore, në këshillat e këshilltarëve për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, duhet debatuar dhe informuar nxënësit për natyrën, motivet, pasojat dhe format e trafikimit. Duhet përforcuar kontrollin në kufij, duhet ushtruar kontroll në objektet turistike hoteliere dhe argëtuese, duhet ashpërsuar ligjet dhe azhuruar gjyqësinë.

Roli i mediave elektronike dhe të shkruara është me rëndësi të madhe, andaj duhet të propozojmë që në çdo muaj në njërën nga TV-të e Kosovës, kjo temë të jetë objekt trajtimi. Lidhur me këtë masë TV-të duhet të nënshkruajnë një Memorandum mirëkuptimi.

OBJEKTIVA 8

4.8. Sistemi i avancuar i barazisë dhe i integritit të fëmijëve minoritarë në shoqërinë kosovare.

Kosova ka dalë nga një luftë e tmerrshme me pasoja të cilat nuk janë evituar ende. Në këtë luftë ka pasur rrënimë, shkatërrime, djegie të pronës (por jo vetëm të pronës, por edhe të njerëzve në mesin e të cilëve ka pasur edhe fëmijë), bagëtisë, pasurive të ndërhuara me dekada. Janë shkatërruar edhe institucionet kulturore dhe arsimore e fetare. Dhunimet, dëbimet, pastrimet etnike, masakrimet mizore dhe njerëzit e pagjetur janë ende plagë të hapura, që përcillen me emocione dhembjeje. Të gjitha këto, kanë bërë që urrejtja ndëretnike, e cila i ka rrënjët edhe në sistemin totalitar komunist para lufte, të jetë e thellë, në momente dhe e tmerrshme. Pa u futur në etiologjinë e saj, urrejtja tani është një rubikon, që ne duhet ta kalojmë. Pas përfundimit të luftës në Kosovë, ç’është e vërteta ka pasur përparime. Bashkësitë etnike minoritare boshnjake, turke RAE- komunitetet janë integruar dhe bashkëpunojnë me bashkësinë shqiptare shumicë. Janë të integruar në sistemin politik, ekonomik, shëndetësor. Distanca më e madhe emocionale ekziston ndërmjet bashkësisë etnike serbe dhe shqiptare, që është pasojë e luftës dhe e trazirave të marsit të vitit 2004. Në këtë distancë emocionale ndikim ka edhe statusi i pazgjidhur politik. Vizioni dhe misioni i kësaj strategjie nuk mund të realizohen nëse jetësohen dokumente dhe standarde ndërkombëtare për pakicat etnike. Në këtë kontekst ne duhet të punojmë që të jetësojmë nenet 11, 12,13,14 dhe 30-të të Konventës për të drejtat e Fëmijës.

Në nenin 30-të të KDF-së thuhet: *“Në shtetet ku ekzistojnë pakicat etnike, fetare apo gjuhësore ose persona me origjinë autokton, çdo fëmije që i përket një minoriteti të tillë, nuk duhet t’i mohohet e drejta për të pasur kulturën e tij, të ushtrojë dhe praktikojë fenë ose të përdorë gjuhën e tij së bashku me anëtarët e tjerë të grupit të tij”*.

TREGUESIT

1. Deri në vitin 2008, duhet të kompletohet korniza juridike për garantimin e barazisë, sigurisë dhe të lirisë së plotë për të gjitha bashkësitë etnike, që jetojnë në Kosovë.

2. Në vitin 2007, duhet të hartohet Programi për edukimin ndër dhe multikulturor.
3. Në vitin 2007, duhet të fillojë zbatimi pilotik i Programit ndër dhe multikulturor.
4. Deri në vitin 2017, shkalla e përfshirjes së fëmijëve në arsimin e detyruar duhet të jetë 99 % për të gjitha bashkësitë etnike.
5. Deri në vitin 2012, për të gjithë nxënësit e të gjitha bashkësive etnike duhet të sigurohen tekstet në gjuhën amtare dhe mësimdhënës të certifikuar dhe të licencuar për të zhvilluar mësimin në gjuhën amtare.

MASAT

Masa 4.2.8.1. Hartimi i kornizës së plotë juridike me të cilën sigurohet barazia e plotë e qytetarëve para ligjit dhe liria e siguria e plotë e lëvizjes.

Përshkrimi

Një pjesë e kornizës ligjore për barazinë e pakicave etnike në Kosovë është miratuar (p.sh. Ligji për përdorimin e gjuhëve dhe sigurinë e pronës, Ligji kundër diskriminimit, Ligji për barazinë gjinore, Rregullorja kundër nxitjes së urrejtjes, mospajtimit dhe jo-tolerancës kombëtare, raciale, fetare apo etnike). Ekziston një bazë e mirë e cila duhet të përsoset dhe të plotësohet, por problemi më i madh është moszbatimi dhe mosrespektimi i ligjeve, për çka duhet paraparë sanksione dhe llogaridhënie për të gjithë ata që e shkelin ligjin.

Duhet miratuar një ligj për mbrojtjen dhe sigurimin e barazisë së pakicave kombëtare.

Masa 4.2.8.2. Të hartohet një Program Nacional i Edukimit Ndër dhe Multikulturor.

Përshkrimi:

Nuk ka shoqëri kohezive dhe miqësore për fëmijë, nëse nuk krijohen ura katrore dhe arsimore ndërmjet bashkësive të ndryshme etnike, që jetojnë në Kosovë. Kosova për të gjithë qytetarët e saj duhet të shndërrohet në një godinë të madhe dhe të përbashkët, pavarësisht nga përkatësia etnike, racore, gjinore, fetare, ekonomike dhe zhvillimore, sepse kjo godinë mund të ruhet nëse ajo konsiderohet pronë e përbashkët. Ne, të gjithë duhet të bëjmë jetë të lumtur, të barabartë, pa strese dhe pa urrejtje.

Kjo godinë do të ketë edhe shumë ura, dyer dhe dritare për të parë nga brenda jashtë, për të dalë dhe për t'u futur në të dhe, me të vetmin qëllim, që kjo godinë me ambientin e vet gjithnjë të jetë më e bukur dhe më e mirë.